



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 114

Datë 24 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 59/2014 datë 12.6.2014	Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë	5075
Vendim i Kuvendit nr. 48/2014 datë 17.7.2014	Për rrëzimin e dekretit nr. 8620, datë 4.7.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”	5083
Ligj nr. 63/2014 datë 26.6.2014	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	5083
Ligj nr. 65/2014 datë 26.6.2014	Për agjencinë e inteligjencës dhe sigurisë së mbrojtjes.....	5086
Ligj nr. 66/2014 datë 26.6.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8488, datë 13.5.1999, “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara”, të ndryshuar	5100
Vendim i Kuvendit nr. 49/2014 datë 17.7.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 2/2014, datë 30.1.2014, “Për miratimin e përbërjes së komisionit të posaçëm për reformën administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	5101
Vendim i Kuvendit nr. 50/2014 datë 17.7.2014	Për një ndryshim në vendimin e kuvendit nr. 48/2013, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar	5101
Rezolutë e Kuvendit datë 10.7.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të autoritetit të mediave audiovizive (AMA) për vitin 2013	5101

Rezolutë e Kuvendit datë 10.7.2014	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit për vitin 2013	5102
Rezolutë e Kuvendit datë 17.7.2014	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2013.....	5104
Dekret nr. 8625 datë 10.7.2014	Për emërim gjyqtari.....	5105
Dekret nr. 8626 datë 10.7.2014	Për emërim gjyqtari.....	5105
Dekret nr. 8631 datë 16.7.2014	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	5105

LIGJ
Nr. 59/2014

PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i sistemit të menaxhimit të karrierës ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e kriterëve për pranimin në Forcat e Armatosura, rendin e gradave, përparimin në gradë dhe karrierë, ndërprerjen e karrierës ushtarake, si dhe autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e karrierës në Forcat e Armatosura.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të këtij ligji janë ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, studentët ushtarakë, si dhe ushtarakët në rezervë.

Neni 4
Juridiksioni territorial

Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë territorit të saj për ushtarakët shqiptarë kur ata janë dërguar me mision, shërbim, studime, stërvitje të përbashkëta, mision diplomatik ose në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe.

Neni 5
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura” është shtetasi shqiptar i titulluar oficer, nënoficer, ushtar nga autoriteti kompetent, që bën betimin ushtarak dhe shërben në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura.

2. “Ushtarak në rezervë” është ushtaraku që ka shërbyer në Forcat e Armatosura dhe, pasi ndërpret

karrierën ushtarake aktive, përfshihet në strukturat rezervë të Forcave të Armatosura.

3. “Ushtarak në lirim” është ushtaraku që ka shërbyer në Forcat e Armatosura dhe, pasi ndërpret karrierën ushtarake aktive, nuk përfshihet në strukturat rezervë të Forcave të Armatosura.

4. “Oficer aktiv i Forcave të Armatosura” është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

5. “Nënoficer aktiv i Forcave të Armatosura” është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

6. “Ushtar/detar aktiv i Forcave të Armatosura” është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

7. “Student ushtarak” është shtetasi shqiptar që është përzgjedhur për t’u arsimuar në institucionet e përgatitjes së oficerëve të rinj, brenda ose jashtë vendit, dhe ka bërë betimin ushtarak.

8. “Kursant” është shtetasi shqiptar:

a) kandidat për oficer aktiv pas përfundimit minimalisht të ciklit të parë të studimeve të larta, brenda ose jashtë vendit, dhe që ndjek kursin përkatës ushtarak në institucionet arsimore ushtarake;

b) kandidat për ushtar, i cili është shpallur fitues pas procedurave të rekrutimit nga institucioni përkatës dhe ndjek kurset për t’u certifikuar për ushtar.

9. “Gradë ushtarake” është titulli dhe shenja që mban ushtaraku i Forcave të Armatosura në uniformën ushtarake.

10. “Gradë për specialitete” është kategoria e gradave ushtarake, e cila u jepet ushtarakëve të profesioneve specifike.

11. “Epror” është ushtaraku i cili, në bazë të gradës apo funksionit, ushtron autoritet mbi ushtarakët vartës.

12. “Vartës” është ushtaraku, i cili është nën autoritetin e një ushtaraku që ka gradë apo funksion më të lartë.

KREU II
GRADAT DHE KARRIERA USHTARAKE NË
FORCAT E ARMATOSURA

Neni 6
Karriera ushtarake

Karriera ushtarake është ecuria në rendin e gradave dhe funksioneve gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak aktiv.

Neni 7
Hierarkia ushtarake

1. Hierarkia ushtarake përfshin rendin e gradave dhe të funksioneve.

2. Rendi i gradave dhe i funksioneve në Forcat e Armatosura shkallëzohet nga më i ulëti në më të lartin, sipas lidhjeve e varësive që kanë ndërmjet tyre.

3. Ushtarakët, në varësi të hierarkisë së funksioneve dhe gradave, janë eprorë dhe vartës.

Neni 8

Kategoritë e ushtarakëve

1. Ushtarakët e Forcave të Armatosura janë ushtarakë të shërbimit aktiv dhe ushtarakë në rezervë.

2. Ushtarakët e shërbimit aktiv janë ushtarakë të shërbimit të përkohshëm dhe ushtarakë të shërbimit të karrierës. Ushtarakët e shërbimit të përkohshëm janë oficerët me gradë “Nëntoger”, “Toger” dhe “Kapiten”, nënoficerët me gradë “Nëntetar” e “Tetar” dhe ushtarët/detarët. Ushtarakë të shërbimit të karrierës janë oficerët me gradë “Major”, “Nënkolonel”, “Kolonel” dhe oficerët me gradë madhore dhe nënoficerët me gradë “Rreshter”, “Kapter” dhe “Kryekapter”.

3. Ushtarakë të shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura janë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë/detarë.

Neni 9

Kontrata e shërbimit ushtarak aktiv

1. Ushtarakët, me pranimin e tyre në shërbimin ushtarak aktiv, nënshkruajnë kontratë, si më poshtë:

a) Për ushtarët/detarët:

i) kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës është 3-vjeçare dhe nuk duhet të kalohet moshë maksimale e përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji;

ii) kontrata nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura. Në emër të Forcave të Armatosura nënshkruajnë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij, komandanti i forcës, komandanti i strukturës mbështetëse apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura.

b) Për nënoficerët:

i) kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës për gradën respektive bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji, dhe nuk duhet të kalohet moshë maksimale e përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji;

ii) kontrata nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura. Në emër të Forcave të Armatosura nënshkruajnë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij, komandanti i forcës, komandanti i strukturës mbështetëse apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura.

c) Për studentët ushtarakë dhe oficerët:

i) kontrata lidhet me fillimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit. Në kontratë përfshihen koha e arsimimit dhe 6 vjet periudhë shërbimi si oficer në Forcat e Armatosura. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës për gradën

respektive bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji, dhe nuk duhet të kalohet moshë maksimale e përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji;

ii) në emër të Forcave të Armatosura për studentët ushtarakë nënshkruan komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, ndërsa për oficerët nënshkruan drejtuesi i njësive së menaxhimit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Në rast shkeljeje të kontratës, shtetasit dhe ushtarakët detyrohen të dëmshpërblejnë shpenzimet për kohën e studimit apo kualifikimit brenda ose jashtë vendit. Urdhri i Ministrisë të Mbrojtjes për shlyerjen e detyrimit në këto raste përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor.

3. Procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak aktiv përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Mbrojtjes.

4. Shtetasit/ushtarakët, që nënshkruajnë kontratë, sipas këtij neni, janë të detyruar të shërbejnë në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, sipas nevojave dhe situatave operacionale, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 10

Subjektet përfituese të gradave ushtarake

Në Forcat e Armatosura gradat u jepen oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve/detarëve, studentëve ushtarakë dhe ushtarakëve në rezervë.

Neni 11

Klasifikimi i gradave ushtarake

Gradat ushtarake në Forcat e Armatosura klasifikohen:

a) Për oficerët aktivë:

i) grada madhore;

ii) grada të larta;

iii) grada të ulëta.

b) Për nënoficerët aktivë:

i) grada të larta;

ii) grada të ulëta.

Neni 12

Gradat ushtarake

1. Gradat ushtarake, sipas klasifikimit dhe shërbimit, janë:

a) Për oficerët aktivë:

Klasifikimi	Grada Forca	Grada Forca Detare
i) Gradë madhore	Tokësore/Ajrore Gjeneral lejtnant	Admiral;
ii) Gradë madhore	Gjeneral major	Nëadmiral;
iii) Gradë madhore	Gjeneral brigade	Kundëradmiral;
iv) Gradë e lartë	Kolonel	Kapiten i rangut I;
v) Gradë e lartë	Nënkolonel	Kapiten i rangut II;
vi) Gradë e lartë	Major	Kapiten i rangut III;
vii) Gradë e ulët	Kapiten	Kapiten Lejtnant;
viii) Gradë e ulët	Toger	Lejtnant;
ix) Gradë e ulët	Nëntoger	Nënlejtnant.

b) Për nënoficerët aktivë:

Klasifikimi	Grada Forca	Grada Forca
	Tokësore/Ajrore	Detare
i) Gradë e lartë	Kryekapter	Kryekapter;
ii) Gradë e lartë	Kapter	Kapter;
iii) Gradë e ulët	Rreshter	Rreshter;
iv) Gradë e ulët	Tetar	Tetar;
v) Gradë e ulët	Nëntetar	Nëntetar

c) Për ushtarët aktivë:

Titulli	Grada Forca	Grada Forca
	Tokësore/Ajrore	Detare
i) Ushtar	Ushtar IV	Detar IV;
ii) Ushtar	Ushtar III	Detar III;
iii) Ushtar	Ushtar II	Detar II;
iv) Ushtar	Ushtar I	Detar I.

ç) Për studentët:

Titulli	Lloji i gradës
Student	Kadet.

2. Studentët shqiptarë, që ndjekin studimet në shkollat ushtarake jashtë vendit, mbajnë uniformën dhe simbolet e gradës së studentit të akademive ushtarake shqiptare, sipas marrëveshjeve dypalëshe me vendet pritëse.

3. Rekrutët, kur hyjnë në shërbimin aktiv, nuk mbajnë gradë deri në përfundimin me sukses të stërvitjes bazë. Pas përfundimit të kësaj periudhe, kandidatët për ushtarë gradohen “Ushtar I” ose “Detar I”.

Neni 13

Koha e qëndrimit në gradë

1. Koha minimale e qëndrimit në një gradë për fitimin e gradës së radhës është:

Forca Tokësore/Ajrore	Forca Detare	Koha në gradë
a) Ushtar I	Detar I	1 vit;
b) Ushtar II	Detar II	1 vit;
c) Ushtar III	Detar III	1 vit;
ç) Ushtar IV	Detar IV	3 vjet;
d) Nëntetar	Nëntetar	3 vjet;
dh) Tetar	Tetar	4 vjet;
e) Rreshter	Rreshter	6 vjet;
ë) Kapter	Kapter	5 vjet;
f) Nëntoger	Nënlejtant	3 vjet;
g) Toger	Lejtant	4 vjet;
gj) Kapiten	Kapiten lejtant	5 vjet;
h) Major	Kapiten i rangut III	6 vjet;
i) Nënkolonel	Kapiten i rangut II	5 vjet;
j) Kolonel	Kapiten i rangut I	5 vjet;
k) Gjeneral brigade	Kundëradmiral	3 vjet;
l) Gjeneral major	Nënadmiral	3 vjet.

2. Në rast mospërparimi në gradë, ushtarët me gradën “Ushtar IV”, nënoficerët me gradë “Nëntetar” dhe oficerët me gradat “Nëntoger”, “Toger” që plotësojnë 14 vite shërbimi aktiv në Forcat e Armatosura, pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, dalin në rezervë. Në rast mospërparimi në gradë, oficerët me gradën kapiten dhe nënoficerët me gradën tetar, që plotësojnë 15 vite shërbimi aktiv në Forcat e Armatosura, pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, dalin në rezervë.

3. Koha e qëndrimit në një gradë në shërbimin aktiv llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të urdhrit përkatës për dhënien e gradës.

4. Koha e shërbimit në rezervë nuk llogaritet si kohë qëndrimi në gradë për gradim në shërbimin aktiv.

5. Kriteret për gradimin e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve në rezervë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 14

Moshë maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv

1. Moshë maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv është:

Forca Tokësore/Ajrore	Forca Detare	Moshë në shërbim aktiv
a) Ushtar I	Detar I	28 vjeç;
b) Ushtar II	Detar II	29 vjeç;
c) Ushtar III	Detar III	30 vjeç;
ç) Ushtar IV	Detar IV	33 vjeç;
d) Nëntetar	Nëntetar	37 vjeç;
dh) Tetar	Tetar	45 vjeç;
e) Rreshter	Rreshter	54 vjeç;
ë) Kapter	Kapter	55 vjeç;
f) Kryekapter	Kryekapter	57 vjeç;
g) Nëntoger	Nënlejtant	30 vjeç;
gj) Toger	Lejtant	35 vjeç;
h) Kapiten	Kapiten lejtant	45 vjeç;
i) Major	Kapiten i rangut III	55 vjeç;
j) Nënkolonel	Kapiten i rangut II	57 vjeç;
k) Kolonel	Kapiten i rangut I	59 vjeç;
l) Gjeneral brigade	Kundëradmiral	61 vjeç;
ll) Gjeneral major	Nënadmiral	63 vjeç;
m) Gjeneral lejtant	Admiral	65 vjeç.

2. Oficeri me gradë madhore, pavarësisht nga mosplotësimi i moshës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, dhe i kriterëve të përcaktuara në nenet 25 dhe 26, të këtij ligji, nxirret në rezervë apo lirim, kur plotëson njërin nga këto kriterë:

a) kur pas kalimit të kohës së qëndrimit në një gradë sipas pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji, nuk ka marrë gradën e radhës;

b) kur nuk ka kuota të lira për konkurrim për gradën e radhës, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve.

3. Oficerët, pas marrjes së gradës “Major” dhe nënoficerët pas marrjes së gradës “Rreshter”, nuk nënshkruajnë kontratë, por vazhdojnë shërbimin aktiv të karrierës dhe shërbejnë në shërbimin aktiv, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

4. Moshë minimale e pranimit në Forcat e Armatosura është 18 vjeç.

5. Shtetasit, në momentin e titullimit oficer aktiv dhe ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç. Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficerë dhe ushtarë/detarë aktivë, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç.

KREU III
TITULLIMI DHE GRADIMI I USHTARAKËVE
AKTIVË

Neni 15

Titullimi dhe gradimi i ushtarëve aktivë

1. “Ushtar/detar aktiv i Forcave të Armatosura” titullohet shtetasi shqiptar që ka kryer minimalisht arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, ka kryer kursin përkatës ushtarak të ushtarit dhe bën betimin ushtarak.

2. Titullimi “Ushtar/detar aktiv” dhe dhënia e gradës së parë të ushtarit/detarit aktiv bëhet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura, i cili ka certifikuar kandidatin në përfundim të kursit.

Shtetasit shqiptar, kandidat për “Ushtar/detar aktiv”, me arsim të lartë, i jepet grada “Ushtar II/detar II”.

3. Gradat e tjera për ushtarët/detarët aktivë jepen nga:

a) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm për ushtarët/detarët që shërbejnë në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm dhe strukturat e varësisë së tyre;

b) komandanti i forcës për strukturën që drejton dhe ato të varësisë;

c) komandanti i strukturës mbështetëse për strukturën që drejton dhe ato të varësisë.

4. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, përcakton me udhëzim procedurat dhe kriteret për rekrutimin e ushtarëve/detarëve aktivë.

Neni 16

Titullimi dhe gradimi i nënoficerëve aktivë

1. “Nënoficer aktiv” titullohet ushtari/detari IV, që ka kryer kualifikimin përkatës të nënoficerit.

2. Titullimi “nënoficer aktiv” dhe dhënia e gradës së parë “Nëntetar” bëhet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura, i cili ka certifikuar kandidatin në përfundim të kursit.

3. Gradat për nënoficerët aktivë jepen me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komisionit të karrierës.

4. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, përcakton me udhëzim procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktivë.

Neni 17

Titullimi dhe gradimi i oficerëve aktivë

1. “Oficer aktiv i Forcave të Armatosura” titullohet shtetasi shqiptar që plotëson një nga kriteret e mëposhtme dhe bën betimin ushtarak:

a) të ketë kryer arsimin e lartë ushtarak brenda ose jashtë vendit;

b) të ketë kryer arsimin e lartë ushtarak dhe ciklin e parë të studimeve të larta pas arsimimit ushtarak jashtë vendit;

c) të ketë kryer ciklin e parë të studimeve të larta, brenda ose jashtë vendit, dhe kursin përkatës ushtarak në institucionet arsimore ushtarake.

2. Titullimi “oficer aktiv” dhe dhënia e gradës së parë të oficerit bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e titullarit të institucionit arsimor dhe stërvitor në Forcat e Armatosura.

3. Grada “Nëntoger” u jepet shtetasve që janë titulluar “oficer aktiv”.

4. Gradat e ulëta dhe të larta të oficerëve jepen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e komisioneve të karrierës.

5. Gradat madhore u jepen oficerëve me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

6. Grada e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe Grada e Komandantit të Forcave të Armatosura në kohë lufte jepen me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit.

Neni 18

Kriteret e përgjithshme për përparimin në gradë

1. Ushtaraku merret në shqyrtim për marrjen e gradës së radhës, kur plotëson kriteret e mëposhtme:

a) të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në një gradë, sipas pikës 1, të nenit 13, të këtij ligji;

b) të ketë arsimimin dhe kualifikimin e nevojshëm për marrjen e gradës së radhës, sipas nenit 20 të këtij ligji;

c) më shumë se gjysma e vlerësimeve vjetore gjatë viteve të qëndrimit në gradën që mban të mos jetë më e ulët se “kënaqshëm”;

ç) të jetë i aftë fizikisht dhe në gjendje shëndetësore të mirë.

2. Nënoficerët me gradë “Nëntetar” dhe oficerët me gradë “Nëntoger”, “Toger”, shqyrtohen dy herë radhazi nga komisionet e karrierës për marrjen e gradës së radhës.

3. Nënoficerët me gradë “Tetar” dhe oficerët me gradë “Kapiten” shqyrtohen tri herë radhazi nga komisionet e karrierës për marrjen e gradës së radhës.

4. Oficerët e karrierës me gradë “Major”, “Nënkolonel”, “Kolonel” dhe nënoficerët e karrierës me gradë “Rreshter” dhe “Kapter” shqyrtohen tri herë radhazi nga komisionet e karrierës për marrjen e gradës së radhës.

5. Oficerët me gradë madhore shqyrtohen vetëm një herë nga komisioni i karrierës për marrjen e gradës së radhës.

6. Gradimi, sipas këtij ligji, bëhet në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, brenda muajit mars të çdo viti, i paraqet Ministrit të Mbrojtjes nevojat

organike të Forcave të Armatosura për çdo gradë, sipas llojit të forcës dhe specialiteteve. Komandantët e forcave dhe komandantët e strukturave mbështetëse, brenda muajit mars të çdo viti, i paraqesin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nevojat organike të strukturave që drejtojnë për çdo gradë, sipas llojit të forcës dhe specialiteteve.

8. Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij neni, miraton rregulloren e aftësive fizike, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Neni 19

Vlerësimi vjetor i ushtarakut

1. Vlerësimi vjetor i ushtarakut është procesi i verifikimit të përgjithshëm vjetor të realizimit të objektivave të përcaktuar në detyrë, i aftësive apo dobësive të ushtarakut në kryerjen e detyrave, si dhe cilësive etike e morale të tij. Vlerësimi i rezultateve synon përmirësimin e aftësive profesionale dhe të cilësisë së shërbimit nga ushtarakët.

2. Ushtaraku vlerësohet në një nga këto nivele:

- a) “Shkëlqyer”;
- b) “Shumë mirë”;
- c) “Kënaqshëm”;
- ç) “Jo gjithnjë i përshtatshëm”;
- d) “Pamjaftueshëm”.

3. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, miraton rregulloren e vlerësimit të ushtarakëve.

Neni 20

Arsimimi dhe kualifikimi për përparim në gradë

1. Ushtarakët e Forcave të Armatosura, për të fituar gradën e radhës, duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit dhe të kualifikimit si më poshtë:

a) Oficerët:

i) Nëntogeri, për të fituar gradën e “Togerit”, të ketë kryer kursin bazë të oficerit ose kurse të njësuara me të, sipas urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes;

ii) Togerit, për të fituar gradën e “Kapitenit”, të ketë kryer kursin e avancuar të oficerit ose kurse të njësuara me të, sipas urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes;

iii) Kapiteni, për të fituar gradën e “Majorit”, të ketë kryer kursin themelor të oficerit të shtabit ose kurse të njësuara me të, sipas urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes;

iv) Majori, për të fituar gradën e “Nënkolonelit”, të ketë kryer kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm ose kurse të njësuara me të, sipas urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes;

v) Nënkoloneli, për të fituar gradën e “Kolonelit”, të ketë kryer kursin e lartë të oficerit ose kurse të njësuara me të, sipas urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes;

vi) Koloneli, për të fituar gradën “Gjeneral brigade”, të ketë kryer kursin e lartë për sigurinë dhe mbrojtjen ose

kurse të njësuara me të, sipas urdhrimit të Ministrit të Mbrojtjes;

vii) gradimi “Gjeneral major/Nënadmiral” dhe “Gjeneral lejtant/Admiral” bëhet në bazë të meritave, përgatitjes dhe aftësive profesionale, të vlerësuara nga Komisioni i Veçantë i Karrierës.

b) Nënoficerët:

i) Nëntetari, për të fituar gradën “Tetar”, duhet të ketë kryer kursin bazë të nënoficerit;

ii) Tetari, për të fituar gradën “Rreshter”, duhet të ketë kryer kursin e avancuar të nënoficerit;

iii) Rreshteri, për të fituar gradën “Kapter”, duhet të ketë kryer kursin e lartë të nënoficerit;

iv) Kapteri, për të fituar gradën “Kryekapter”, duhet të ketë kryer kursin e kryekapterit.

c) Ushtarët:

i) Kursanti, për të fituar gradën “Ushtar/detar I”, duhet të ketë kryer stërvitjen bazë;

ii) Ushtari/detari I, për të fituar gradën “Ushtar/detar II”, duhet të ketë kryer stërvitjen individuale të avancuar.

2. Kurset dhe kualifikimet e kryera brenda dhe jashtë vendit, për efekt të përparimit në gradë, për të gjitha llojet e gradave, njësohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

3. Kurset dhe kualifikimet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, që rregullon aktivitetin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe të shërbimit të policisë kriminale ushtarake, njësohen me kurset dhe kualifikimet e kërkuara për marrjen e gradave, sipas këtij ligji, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Ministria e Mbrojtjes, me qëllim arsimimin e shtetasve që dëshirojnë të bëhen pjesëtarë të Forcave të Armatosura, zhvillon politika dhe planifikon fonde buxhetore, si dhe mund të lidhë marrëveshje me institucione të arsimit parauniversitar, profesional dhe të lartë, publike dhe private.

Neni 21

Kriteret e përparimit në gradë për specialitetet

1. Përparimi në gradë për oficerët deri nënkolonel/kapiten i rangut II dhe nënoficerët deri kapter, që kryejnë detyra organike në specialitete në Forcat e Armatosura, si mjekë dhe personel i orkestrës frymore, bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në nenet 13 dhe 14, të këtij ligji, dhe në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura.

2. Specifika e këtyre gradave bëhet e dallueshme nëpërmjet dizenjimit të veçantë të tyre.

3. Gradat e përfituara sipas këtij neni ruajnë vlerën juridike vetëm kur mbajtesit e tyre ushtrojnë funksione në specialitetin që është bërë parakusht për marrjen e gradës. Kur ushtaraku nuk ushtron detyrën sipas specialitetit të tij, mban të njëjtën gradë.

4. Ushtarakët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, përfitojnë grada të tjera ushtarake të sistemit të karrierës,

kur plotësojnë kriteret e tjera të këtij ligji për gradën respektive.

5. Numri i përgjithshëm i personelit, që mban grada për specialitetet, përcaktohet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Përcaktimi i numrit të personelit që mban grada për specialitete bëhet duke marrë parasysh misionin dhe detyrat e strukturave të Forcave të Armatosura.

Neni 22

Komisionet e karrierës

1. Komisionet e karrierës janë autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e përparimit të ushtarakëve në gradë, si dhe për kualifikimet që shërbejnë për marrjen e gradës së radhës.

2. Komisionet e karrierës janë:

a) komisioni i veçantë, i cili vlerëson oficerët për marrjen e gradave madhore;

b) komisioni i lartë, i cili vlerëson oficerët për marrjen e gradave major/kapiten i rangut III, nënkolonel/kapiten i rangut II, kolonel/kapiten i rangut I, si dhe nënoficerët për marrjen e gradës kryekapter;

c) komisioni i zakonshëm për oficerët me grada të ulëta, i cili vlerëson oficerët për marrjen e gradave toger/lejtant dhe kapiten/kapiten lejtant;

ç) komisioni i zakonshëm për nënoficerët, i cili vlerëson nënoficerët për marrjen e gradave të radhës, përjashtuar gradën kryekapter.

3. Përbërja e komisioneve të karrierës:

a) Komisioni i veçantë përbëhet nga:

i) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm kryetar;

ii) dy gjeneralë majorë/nënadmiralë anëtarë;

iii) dy gjeneralë brigade/kundëradmiralë anëtarë.

b) Komisioni i lartë përbëhet nga:

i) një gjeneral major/nënadmiral kryetar;

ii) tre gjeneralë brigade/kundëradmiralë anëtarë;

iii) tre kolonelë/kapitenë të rangut I anëtarë.

Në rastet kur shqyrtohen oficerë dhe nënoficerë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në komision marrin pjesë respektivisht edhe dy kolonelë kur shqyrtohen oficerët dhe dy kryekapterë kur shqyrtohen nënoficerët nga kjo Agjenci, me të drejtë vote.

Në rastet kur shqyrtohen nënoficerët e forcave dhe strukturave mbështetëse për marrjen e gradës kryekapter, në komision marrin pjesë edhe dy kryekapterë, me të drejtë vote.

Komisioni i lartë mblidhet sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes;

c) Komisioni i zakonshëm për oficerët me grada të ulëta përbëhet nga:

i) një gjeneral brigade/kundëradmiral kryetar;

ii) gjashtë kolonelë/kapitenë të rangut I anëtarë.

Në rastet kur shqyrtohen oficerë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në komision marrin pjesë edhe dy kolonelë nga kjo Agjenci, me të drejtë vote.

Komisioni i zakonshëm për oficerët me grada të ulëta mblidhet sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes.

ç) Komisioni i zakonshëm për nënoficerët përbëhet nga:

i) një gjeneral brigade/kundëradmiral kryetar;

ii) tre kolonelë/kapitenë të rangut I anëtarë;

iii) tre kryekapterë anëtarë.

Në rastet kur shqyrtohen nënoficerë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në komision marrin pjesë edhe dy kryekapterë/kapterë nga kjo Agjenci, me të drejtë vote.

Komisioni i zakonshëm për nënoficerët mblidhet sipas afateve të përcaktuara në urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes.

4. Nuk bëjnë pjesë në komisionet e karrierës:

a) anëtarët e kabinetit të Ministrit të Mbrojtjes;

b) ushtarakët e shërbimeve inteligjente dhe informative, me përjashtim të rasteve të parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 3, të këtij neni.

5. Komisionet e karrierës i përfundojnë procedurat e punës së tyre brenda muajit korrik të çdo viti, me përjashtim të Komisionit të Veçantë.

6. Komisionet e karrierës ngrihen me urdher të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

7. Funksionimi, procedurat e punës, mënyra e vlerësimit të ushtarakëve, gjatë procedurave për vlerësimin e përparimit të ushtarakëve në gradë, si dhe për kualifikimet përcaktohen me urdher të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

8. Përjashtim nga sistemi i vlerësimit me pikë bëhet për marrjen e gradave gjeneral major/nënadmiral dhe gjeneral lejtant/admiral, të cilat vlerësohen në bazë të meritave, përgatitjes dhe aftësive profesionale.

Neni 23

Njësimi i gradave me funksionet organike

Njësimi i gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 24

Pezullimi i ushtarakëve nga detyra

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve të punës për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, ushtaraku emërohet në përputhje me gradën që mban, me përjashtim të rastit kur dënohet me burgim.

2. Ushtaraku pezullohet:

a) kur ndaj tij fillon ndjekja penale dhe vendoset masa e sigurisë arrest në burg ose arrest në shtëpi, deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata ose kur ndaj tij fillon procedimi penal për vepra penale që lidhen me detyrën;

b) për periudha studimi më shumë se 6 muaj, të ndërmarra me nismën e vetë ushtarakut dhe në lidhje me profesionin që ai ushtron;

c) me kërkesën e ushtarakut për të shoqëruar bashkëshortin/bashkëshorten, që emërohet jashtë shtetit në funksione zyrtare. Në këtë rast, pezullimi nuk mund të zgjatë më shumë se katër vjet.

3. Gjatë periudhës së pezullimit, ushtaraku nuk paguhet. Në rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë ushtaraku deklarohet i pafajshëm, ai emërohet në detyrë, i jepet paga bazë me të gjitha përfitimet e tjera që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e kohës së pezullimit nga detyra njihet si vjetërsi grade dhe shërbimi në Forcat e Armatosura, kur pezullimi ndodh për rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, dhe çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë ushtaraku deklarohet i pafajshëm, ndërsa për rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij neni, periudha e pezullimit njihet vetëm për efekt të vjetërsisë së gradës.

5. Pezullimi i oficerit nga detyra bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, ndërsa pezullimi i nënoficerit dhe ushtarit/detarit bëhet me urdhër të autoritetit që ka kompetencën e emërimit.

Neni 25

Dalja në rezervë e ushtarakëve

1. Ushtaraku del në rezervë nga shërbimi aktiv kur ka plotësuar njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) ka plotësuar afatin e parashikuar në kontratë;

b) ka plotësuar moshën e përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji;

c) ka plotësuar kohën e qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji, për gradat respektive;

ç) ka dy vlerësime vjetore “pamjaftueshëm” gjatë kohës së qëndrimit në një gradë;

d) paraqet kërkesën dhe ajo miratohet nga organi përgjegjës. Organi përgjegjës kthen përgjigje brenda tre muajve. Në rast se organi përgjegjës nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, kërkesa quhet e miratuar.

dh) kur bëhen shkurtime në numrin e përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura. Në këtë rast, kriteret e përzgjedhjes së ushtarakëve që dalin në rezervë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, sipas propozimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm del në rezervë me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit.

3. Oficerët me gradë madhore dalin në rezervë me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

4. Oficerët, përveç atyre që mbajnë grada madhore, dalin në rezervë me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

5. Nënoficerët dalin në rezervë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

6. Ushtarët/detarët dalin në rezervë me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

Neni 26

Dalja në lirim e ushtarakëve

1. Ushtaraku del në lirim nga shërbimi aktiv kur ka plotësuar njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) ka plotësuar moshën për pension pleqërie;

b) dënohet me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) shpallet i paafte nga ana shëndetësore për shërbim ushtarak me vendim të komisionit përkatës mjekësor;

ç) paraqet kërkesën dhe ajo miratohet nga organi përgjegjës. Organi përgjegjës kthen përgjigje brenda tre muajve. Në rast se organi përgjegjës nuk kthen përgjigje brenda këtij afati, kërkesa quhet e miratuar;

d) ka kryer shkelje shumë të rënda disiplinore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

dh) në rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 25, të këtij ligji, kur është mbi moshën e shërbimit ushtarak në rezervë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë.

2. Në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni, ushtaraku shkarkohet nga detyra dhe del në lirim.

3. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm del në lirim me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Kryeministrit.

4. Oficerët me gradë madhore dalin në lirim me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

5. Oficerët, përveç atyre që mbajnë grada madhore, dalin në lirim me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

6. Nënoficerët dalin në lirim me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

7. Ushtarët/detarët dalin në lirim me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me propozimin e komandantit të forcës ose komandantit të strukturës mbështetëse.

Neni 27

Periudha e qëndrimit të ushtarakut në dispozicion

1. Kur ushtaraku lirohet nga detyra, ai emërohet menjëherë në një detyrë tjetër, në përputhje me arsimimin, specialitetin dhe funksionet organike sipas gradës që mban.

2. Në raste të veçanta, emërimi në një detyrë tjetër bëhet brenda një periudhe 2-mujore. Gjatë kësaj periudhe, ushtaraku i liruar nga detyra paguhet me pagën mujore të gradës që mban, por jo më shumë se dy muaj.

Neni 28

Ankimi për procedurën e vlerësimit të komisioneve të karrierës

1. Ushtarakët, që janë marrë në shqyrtim për gradën e radhës, mund të ankohen për vlerësimin e komisionit të karrierës te Ministri i Mbrojtjes. Ankimet bëhen brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së rezultatit vetëm një herë.

2. Për shqyrtimin e ankesave, Ministri i Mbrojtjes krijon një komision të posaçëm të drejtuar nga një ushtarak me gradë madhore.

3. Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesave vendos lënien në fuqi të vlerësimit të komisioneve të karrierës ose ndryshimin e këtij vlerësimi.

4. Procedurat dhe funksionimi i komisionit të shqyrtimit të ankesave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

Neni 29

Përfundimi i procedurave të gradimit

Gradimet e radhës bëhen vetëm pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit të ankesave nga komisioni, sipas nenit 28 të këtij ligji.

Neni 30

Ankimi për procedurën e daljes në rezervë/lirim

1. Për mosmarrëveshjet që lindin për nxjerrjen në rezervë/lirim nga shërbimi ushtarak në Forcat e Armatosura, ushtarakut, përveç atij me gradë madhore, i lind e drejta të ankohet te Ministri i Mbrojtjes brenda 30 ditëve nga data e njoftimit për nxjerrjen në rezervë/lirim.

2. Ministri i Mbrojtjes, brenda 30 ditëve, shqyrton dhe vendos për ankesën.

3. Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet ose organi kompetent nuk e ka shqyrtuar kërkesën në afatin e caktuar në pikën 2, të këtij neni, ushtarakut i lind e drejta të ankohet në gjykatën administrative brenda 30 ditëve.

4. Kur akti i shfuqizuar nga gjykata ka të bëjë me nxjerrjen në rezervë ose në lirim të ushtarakut, ai

rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel me atë të mëparshmen.

Neni 31

Rikthimi në shërbimin aktiv

1. Ushtarakët në rezervë rikthehen në shërbimin aktiv vetëm në rastet kur:

a) bëhen shtesa në numrin e përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura;

b) bëhet mobilizimi i përgjithshëm ose i pjesëshëm.

2. Në rastet e rikthimit në Forcat e Armatosura, ushtarakët mbajnë gradën që kishin në çastin e daljes në rezervë.

Neni 32

Mospërputhjet gradë-funksion

1. Në rastet e riorganizimit strukturor të Forcave të Armatosura, për mungesë funksioni organik, ushtaraku, me pëlqimin e tij, mund të emërohet në një funksion më të ulët, duke mbajtur gradën që ka, por jo për më shumë se 3 vjet.

2. Mospërputhja e gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura nuk duhet të kalojë masën 10 për qind të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak.

KREU IV

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33

Zëvendësimi i emërtesave

Emërtesa “Ushtar me pagesë/Profesionist”, e përdorur në legjislacionin në fuqi, zëvendësohet me emërtesën “Ushtar/Detar”.

Neni 34

Rregullimi i gradave të ushtarëve

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji:

a) ushtarëve profesionistë I , që kanë më pak se 1 vit kohë qëndrimi në gradë, u jepet grada “Ushtar I/Detar I”;

b) ushtarëve profesionistë I, që kanë më shumë se 1 vit kohë qëndrimi në gradë dhe që kanë përfunduar stërvitjen individuale të avancuar (SIA) u jepet grada “Ushtar II/Detar II”;

c) ushtarëve profesionistë II, që kanë më pak se 1 vit kohë qëndrimi në këtë gradë, u jepet grada “Ushtar II/Detar II”;

ç) ushtarëve profesionistë II, që kanë më shumë se 1 vit kohë qëndrimi në këtë gradë dhe kanë përfunduar SIA-n u jepet grada “Ushtar III/Detar III”;

d) ushtarëve profesionistë II që kanë më shumë se 2 vite kohë qëndrimi në këtë gradë dhe vlerësime “shumë mirë” apo “shkëlqyeshëm” në gradën e ushtarit profesionist u jepet grada “Ushtar IV/Detar IV”.

Neni 35

Implementimi i daljes në rezervë/lirim

Zbatimi i neneve 13 dhe 14, të këtij ligji, bëhet duke mos cenuar operacionalitetin dhe gatishmërinë e strukturave të Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, miraton planin e daljes në rezervë ose lirim të ushtarakëve, kur dalja në rezervë ose lirim sjell cenimin e operacionalitetit dhe gatishmërisë së strukturave të Forcave të Armatosura.

Neni 36

Referenca e jashtme

Kudo në legjisllacionin në fuqi, ku bëhet referim në ligjin nr. 9171, datë 22.1.2004, “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, referenca do të konsiderohet e bërë në këtë ligj.

Neni 37

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5, të nenit 13, dhe të nenit 23, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pika 3; 15, pika 4; 16, pika 4; 18, pika 8; 19, pika 3; 20, pikat 2 dhe 3; 21, pika 1; 22, pika 7, dhe 28, pika 4, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 38

Shfuqizime

Ligji nr. 9171, datë 22.1.2004, “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 39

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 12.6.2014

VENDIM

Nr. 48/2014

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 8620, DATË 4.7.2014, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, “PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR. 59/2014, “PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 8620, datë 4.7.2014, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir Meta

Miratuar në datën 17.7.2014

LIGJ

Nr. 63/2014

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8872, DATË 29.3.2002, “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) një përfaqësues i njësisë arsimore vendore (drejtorisë arsimore rajonale/zyrës arsimore), që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së, (shkollat publike profesionale);”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Të drejtat dhe detyrat e tjera të bordit të shkollave profesionale, mandati, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe funksionimi i tij përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit.

Të drejtat dhe detyrat e tjera të bordit të qendrave të formimit profesional, mandati, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe funksionimi i tij përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.”.

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Licencimi i institucioneve jopublike të arsimit dhe formimit profesional

Licencimi i institucioneve jopublike të arsimit profesional dhe/ose subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional bëhet në bazë të kushteve e të kriterëve që përcaktohen në udhëzimet e përbashkëta, të nxjerra për to nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe ministri përgjegjës për çështjet e arsimit. Ky proces kryhet në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Licencimeve.”.

Neni 3

Në nenin 9, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit për programet mësimore dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale.”.

Neni 4

Në nenin 10, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Në shkollat profesionale pranohen të gjithë individët që kanë përfunduar arsimin bazë dhe kanë marrë dëftesën e lirit. Kriteret e pranimeve dhe procedurat e regjistrimit vendosen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale.”.

Neni 5

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Kalimi nga një nivel/drejtim i arsimit dhe formimit profesional në një tjetër

1. Hyrja, vijimi dhe transferimi nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në një nivel/drejtim tjetër bëhet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

2. Transferimi nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në arsimin e mesëm të lartë ose nga arsimit i mesëm i lartë në arsimin profesional bëhet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit.”.

Neni 6

Në nenin 13, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Vlerësimi përfundimtar i nxënësve dhe i kursantëve në arsimin dhe formimin profesional publik dhe atë jopublik, të akredituar, bëhet në bazë të provimeve, me pjesëmarrjen edhe të partnerëve socialë për fushat profesionale.

Kriteret dhe rregullat e provimeve përcaktohen nga ministritë përkatëse, për provimet e niveleve të arsimit profesional nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ndërsa për provimet e Maturës Shtetërore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet sociale dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e arsimit.”.

Neni 7

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14 Certifikimi

1. Ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe ministri përgjegjës për çështjet e arsimit, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumenteve të certifikimit për nxënësit në sistemin e arsimit profesional, sipas niveleve të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Ministri përgjegjës për çështjet sociale përcakton llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumenteve të certifikimit për kursantët në sistemin e formimit profesional.”.

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Këshillimi dhe orientimi në arsimin dhe formimin profesional

1. Këshillimi dhe orientimi për karrierë është pjesë integrale e të gjitha programeve të ofruara nga institucionet e arsimit dhe formimit profesional.

2. Me këshillimin dhe orientimin në arsimin dhe formimin profesional synohet që të ndihmohen të gjithë shtetasit në zgjedhjen e arsimimit, të profesionit, të formimit, të riformimit dhe të riaftësimin profesional më të përshtatshëm për interesat dhe mundësitë fizike e mendore të tyre.

3. Ministri përgjegjës për çështjet sociale përcakton mënyrën e ofrimit të këshillimit dhe orientimit për karrierë nga institucionet e AFP-së.

Neni 9

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Dokumentimi, informacioni dhe statistikat

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit janë përgjegjëse për dokumentimin, dhënien e informacionit dhe mbajtjen e statistikave të arsimit dhe formimit profesional.

2. Ministrinë e tjera, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe të gjitha institucionet e tjera të sistemit të AFP-së, në nivel kombëtar apo vendor, janë të detyruara të japin informacion për veprimtarinë e AFP-së në këto ministri.

3. Procedurat e mbledhjes, të raportimit të informacionit dhe shpeshësia e dhënies së informacionit përcaktohen me udhëzim të dy ministrive përgjegjëse.”.

Neni 10

Në nenin 17, pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Trajnimi dhe kualifikimi i personelit të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, është përgjegjësi e Ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit.

4. Trajnimi dhe kualifikimi i personelit të përmendur në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2, të këtij neni, është përgjegjësi e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale”.

Neni 11

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Vlerësimi i sistemit

Mekanizmat e zhvillimit dhe të vlerësimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional janë përgjegjësi e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale në bashkëpunim me ministrinë përkatëse.”.

Neni 12

Në nenin 20, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Institucionet dhe organizmat përgjegjës të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri janë:

- a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- b) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- c) Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional;
- ç) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;
- d) Inspektorati Shtetëror i Arsimit;

- dh) Shërbimi Kombëtar i Punësimit;
- e) institucionet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- ë) institucionet e tjera publike dhe jopublike, të përcaktuara me akte nënligjore.”.

Neni 13

Në nenin 21, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional përbëhet nga 9 anëtarë:

- a) Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kryetar;
- b) një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- c) një përfaqësues i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
- ç) një përfaqësues i Ministrisë së Financave;
- d) një përfaqësues i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- dh) dy përfaqësues të organizatave të punëdhënësve;
- e) dy përfaqësues të organizatave të punëmarrësve.”.

Neni 14

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

Kompetencat e ministrisë përgjegjëse për çështjet e arsimit në fushën e arsimit profesional

Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit ka këto kompetenca:

- a) përcakton kriteret e përgjithshme për kualifikimin dhe certifikimin e personelit mesimdhënës në arsimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale;
- b) harton dhe zbaton politika të zhvillimit profesional të mësuesve të kulturës së përgjithshme, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 17, dhe akrediton programe trajnuese;
- c) realizon testimin dhe certifikimin e nxënësve të shkollave të arsimit profesional, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale dhe me institucionet e specializuara;
- ç) miraton kurrikulën e lëndëve të përgjithshme;
- d) përcakton kriteret e përgjithshme për marrjen në punë, kualifikimin dhe certifikimin e mësuesve të kulturës së përgjithshme në arsimin profesional.”.

Neni 15

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Kompetencat e ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale në fushën e arsimit dhe formimit profesional

Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka këto kompetenca:

a) përpunon, zhvillon dhe zbaton politikat për reformimin dhe modernizimin e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me drejtimit europiane të zhvillimit të AFP-së;

b) përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve që ofrojnë arsim dhe formim profesional;

c) përcakton kriteret e përgjithshme dhe procedurat për marrjen në punë të personelit mësimdhënës, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 17, si dhe për kualifikimin e për certifikimin e personelit mësimdhënës, të përcaktuar në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2, të nenit 17, në bashkëpunim me institucionet e specializuara;

ç) përcakton, me udhëzim të veçantë, kriteret dhe procedurat e emërimit e të shkarkimit nga puna të drejtuesve të institucioneve ofruese të arsimit dhe formimit profesional. Emërimi i personelit të institucioneve ofruese të AFP-së është kompetencë e drejtuesit përkatës të institucioneve ofruese të AFP-së;

d) krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e arsimit dhe formimit profesional në varësi të saj, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

dh) në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit, harton akte nënligjore për statusin e institucioneve publike ofruese të arsimit dhe formimit profesional për shkallën e autonomisë së tyre e për funksionimin e bordit;

e) bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Licencimeve për licencimin e subjekteve që kryejnë veprimtari të arsimit dhe formimit profesional;

ë) miraton kurrikulat e nivelit qendror të përgatitjes profesionale për institucionet ofruese të AFP-së;

f) merr pjesë në vlerësimin përfundimtar dhe certifikimin e kursantëve në institucionet e formimit profesional;

g) mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, që janë nën përgjegjësinë e saj, në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Arsimit;

gj) harmonizon arsimin dhe formimin profesional, në përputhje me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal, dhe me kërkesat e tregut të punës;

h) nxjerr akte nënligjore që ofruesit e arsimit dhe formimit profesional publik dhe jopublik të zhvillojnë shërbime për llogari të të tretëve.”.

Neni 16

Në nenin 24/1 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj zhvillimin e një sistemi kombëtar e unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar, bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.

2. Shkronja “b”, e pikës 2, ndryshohet si më poshtë:

“b) harton plane dhe programe për zhvillimin e sistemit të AFP-së, që miratohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.”.

Neni 17

Dispozitë kalimtare

Në periudhën kalimtare të transferimit të kompetencave të arsimit profesional, ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit dhe ministria përgjegjëse për çështjet sociale nxjerrin akte nënligjore të përbashkëta, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.6.2014

Shpallur me dekretin nr. 8632, datë 18.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 65/2014

PËR AGJENCINË E INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe fushën e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe rregullon pozitën juridike e administrative, karrierën, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësit të kësaj agjencie.

Neni 2

Misioni

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes mbështet autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura dhe Forcat e Armatosura me inteligjencë në fushën e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, në përmbushje të misionit të tyre kushtetues.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij, ku kryejnë mision Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në zonat e interesit ose zonat e përgjegjësive nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ushtron kompetencat e saj mbi veprimtari që lidhen me kërcënime ose rreziqe që synojnë të cenojnë ose cenojnë Forcat e Armatosura në realizimin e misionit të tyre kushtetues.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Inteligjencë” është informacioni përfundimtar, i përfuar nga procesi i përpunimit, analizimit e vlerësimit të të dhënave dhe informacionit të natyrës së zbulimit, kundërzbulimit e sigurisë, objekt i fushës së veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. “Zbulim” është veprimtaria që ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave ose informacionit për kërcënime dhe rreziqe që vijnë nga jashtë, që synojnë të cenojnë ose cenojnë Forcat e Armatosura.

3. “Kundërzbulim” është veprimtaria që ka të bëjë me grumbullimin e të dhënave ose informacionit për kërcënime dhe rreziqe që vijnë nga brenda, nga shërbime të huaja të inteligjencës, organizata ose individë të përfshirë në spiunazh, sabotazh, subversion, terrorizëm ose krim të organizuar, që synojnë të cenojnë ose cenojnë Forcat e Armatosura, si dhe kundërvëprimin ndaj tyre.

4. “Siguri” është veprimtaria që konsiston në grumbullimin e të dhënave ose informacionit për veprimtari që cenojnë ose synojnë të cenojnë sigurinë fizike të personelit, të informacionit, të rrjeteve të komunikimit, shkëmbimit, transmetimit të informacionit të klasifikuar “sektet shtetëror” ose të NATO-s.

5. “Kërkesa strategjike vjetore për inteligjencë” janë nevojat për mbështetje me inteligjencë që kanë autoritetet e komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura dhe institucionet e tjera të vendit ose të huaja, ku Shqipëria është palë, për zbulim, kundërzbulim dhe siguri në fushën e mbrojtjes.

6. “Zonë përgjegjësie” është hapësira gjeografike ku kryejnë mision Forcat e Armatosura, në të cilën Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është përgjegjëse të grumbullojë dhe të prodhojë inteligjencë, në përmbushje të misionit të saj.

7. “Zonë interesi” është hapësira gjeografike, për të cilën kërkohet prodhim inteligjence, në përmbushje të misionit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

8. “Qendër inteligjence” është një strukturë ose njësi e përkohshme dhe e lëvizshme që krijohet dhe funksionon jashtë vendit, në kuadër të komandave operacionale të Forcave të Armatosura.

9. “Operacion” është tërësia e veprimeve të organizuara, sipas një ideje për të zgjidhur detyra të caktuara strategjike dhe operative.

10. “Fondi specifik operativ” është pjesa e buxhetit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes që përdoret për të shpërblyer burimet e informacionit, shpenzimet për sigurimin e operacionit, blerjen dhe marrjen me qira të objekteve e të mjeteve në funksion të veprimtarive operative.

11. “Verifikimi i pastërtisë së figurës së personelit” është proces verifikimi, shqyrtimi dhe vlerësimi, që i referohet kryerjes së një kontrolli të kujdesshëm dhe kritik për një individ apo subjekt, përpara se atij t’i ofrohet një punë e rëndësishme që kërkon ruajtjen e sekretit, besueshmërinë, besnikërinë e përshtatshmërinë për një detyrë që ka të bëjë me sigurinë kombëtare.

12. “Kushti i sigurisë” është kontrolli paraprak për përshtatshmërinë e personit që aplikon për t’u pranuar në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

13. “Certifikatë sigurie” është dokumenti i lëshuar nga autoriteti përkatës shtetëror i sigurisë, pas kryerjes së procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës, që identifikon individin ose subjektin për të pasur të drejtë njohjeje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” ose të NATO-s.

14. “Punonjës” është shtetasi shqiptar, ushtarak ose civil, që plotëson kriteret e arsimit dhe kualifikimit përkatës, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe që është pranuar në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

15. “Nevojë për njohje” është nevoja e njohjes së punonjësit ose subjektit me informacion të klasifikuar “sekret shtetëror” ose të NATO-s, për shkak të funksionit dhe kryerjes së detyrës.

Neni 5

Parimet e veprimtarisë

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes organizohet dhe funksionon në bazë të këtyre parimeve:

- a) ligjshmëria;
- b) objektiviteti dhe paanësia;
- c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ç) asnjëansia politike;
- d) menaxhimi dhe kontrolli i centralizuar;
- dh) bashkëveprimi ndërinstitucional;
- e) ruajtja e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, formave dhe metodave të punës;
- ë) kontrolli dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së saj.

KREU II

ORGANIZIMI I AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 6

Organizimi

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Mbrojtjes.

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes organizohet në nivel drejtorie të përgjithshme dhe funksionon në mënyrë të centralizuar, me struktura vartëse në territorin ku kryejnë veprimtari dhe mision Forcat e Armatosura, brenda dhe jashtë vendit, sipas zonave të përgjegjësive dhe zonave të interesit.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka stemën dhe flamurin e vet, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

3. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes mban numrin kodik dhe atë luftarak, sipas përcaktimeve të autoriteteve ushtarake.

4. Struktura dhe organika analitike e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

5. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për ruajtjen, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve të krijuara gjatë veprimtarisë së saj, ka arkivin e vet, që funksionon sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

Neni 7

Detyrat e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kryen këto detyra:

a) përpunon kërkesat strategjike vjetore për inteligjencë;

b) paraqet, nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes, produkt inteligjence gjithëburimshe, të nivelit strategjik, për autoritetet e komandimit të Forcave të Armatosura, në përputhje me parimin “nevojë për njohje”;

c) paraqet, nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes produkt inteligjence gjithëburimshe, të nivelit operacional, për autoritetet e tjera të drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura, në përputhje me parimin “nevojë për njohje”;

ç) grumbullon, përpunon, vlerëson, analizon dhe shpërndan të dhëna e informacione, si dhe paraqet produkt inteligjence gjithëburimshe për Ministrin e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, lidhur me sisteme mbrojtjeje, grupe

e organizata me kapacitete kërcënuese të vendeve të huaja, aktivitete të subjekteve, të cilat mund të kërcënojnë ose të rrezikojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura;

d) merr pjesë në procedurat për pajisjen me “certifikatë sigurie” të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes, të Forcave të Armatosura dhe “certifikatë sigurie industriale” të subjekteve që kërkojnë të hyjnë në marrëdhënie me to;

dh) grumbullon, përpunon, vlerëson, analizon, shpërndan të dhëna e informacione dhe paraqet produkt inteligjence gjithëburimshe për Ministrin e Mbrojtjes, lidhur me kërcënime të natyrës së terrorizmit, ekstremizmit, spiunazhit, sabotazhit, diversionit, subversionit, armëve të shkatërrimit në masë, kërcënimeve kibernetike e krimin të organizuar ndaj kapaciteteve mbrojtëse të vendit;

e) prodhon produkt inteligjence dhe shpërndan të dhëna në interes të operacioneve të Forcave të Armatosura dhe misioneve jashtë vendit, ku janë përfshirë kontingjentet dhe misionet ushtarake shqiptare;

ë) paraqet produkt inteligjence për gjendjen e sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura;

f) shkëmben produkt inteligjence, bashkëpunon dhe kryen operacione të përbashkëta me struktura të inteligjencës së NATO-s dhe BE-së, me shërbime dhe me agjenci të inteligjencës së vendeve anëtare të NATO-s e të BE-së dhe agjencitë partnere në interes të mbrojtjes kolektive;

g) garanton sigurinë e veprimtarisë së vet, të personelit, të informacionit, infrastrukturës dhe të sistemeve të komunikimit, shkëmbimit, transmetimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” ose të NATO-s;

gj) kontribuon me personel, inteligjencë dhe qendra inteligjence në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO, BE, OKB dhe në çdo organizëm tjetër ndërkombëtar ku shteti shqiptar është ose synon të bëhet palë;

h) organizon dhe kryen arsimim dhe trajnim profesional për punonjësit e strukturave të inteligjencës ushtarake, në kuadër të sistemit arsimor të Ministrisë së Mbrojtjes, të NATO-s dhe në kuadër të bashkëpunimit me shërbimet homologe dhe partnere;

i) kryen detyra të tjera brenda misionit të saj, të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të kësaj Agjencie.

j) në zbatim të shkronjave “ç”, “dh”, “e”, “ë” dhe “f”, Ministri i Mbrojtjes miraton rregullore me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

Neni 8

Ministri i Mbrojtjes

1. Ministri i Mbrojtjes është autoriteti më i lartë përgjegjës për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Ministri i Mbrojtjes raporton para Kryeministrit për drejtimin dhe zbatimin e politikave shtetërore në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Ministri i Mbrojtjes ushtron këto kompetenca mbi veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes:

a) përcakton përparësitë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, bazuar në politikën shtetërore dhe miraton, çdo fillim viti, kërkesat strategjike vjetore për inteligjencë për këtë Agjenci;

b) përcakton zonat e përgjegjësive dhe zonat e interesit, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

c) informon Kuvendin, Presidentin e Republikës dhe Kryeministrin për aktivitetin e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

ç) miraton politikat në fushat e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

d) nxjerr urdhra dhe udhëzime në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

dh) jep plotfuqi për Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe me strukturat e inteligjencës brenda dhe jashtë vendit;

e) miraton tabelën e organizimit dhe të pajisjeve (TOP) të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie;

ë) emëron, liron ose shkarkon nga detyra, komandon, nxjerr në rezervë apo lirim punonjës in ushtarak oficer, dhe emëron, liron ose shkarkon nga detyra punonjës in civil, ekuivalent me oficer sipas tabelës së organizimit të pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie;

f) miraton krijimin e qendrave të inteligjencës, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

g) miraton kryerjen e operacioneve të veçanta me struktura të inteligjencës së NATO-s dhe të BE-së, me shërbime e agjenci të inteligjencës së vendeve anëtare të NATO-s e të BE-së, si dhe me agjencitë partnere në interes të mbrojtjes kolektive;

gj) miraton rregullat e funksionimit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të saj.

Neni 9

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është autoriteti më i lartë drejtues

dhe përgjegjës për veprimtarinë e institucionit.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes këshillon Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për çështje të zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë së mbrojtjes.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është ushtarak aktiv.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga Ministri i Mbrojtjes.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është autoriteti që përfaqëson strukturat e inteligjencës ushtarake shqiptare në marrëdhëniet me institucionet brenda vendit, NATO-n, BE-në dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) drejton, organizon dhe menaxhon veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi;

b) siguron zbatimin e ligjshmërisë për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi;

c) zbërthen dhe zbaton direktivën e Ministrit të Mbrojtjes për çështjet e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë në fushën e mbrojtjes;

ç) organizon punën për përmbushjen e kërkesave strategjike vjetore për inteligjencë;

d) informon dhe bashkëpunon me autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura për çështje që kanë lidhje me kërcënime të natyrës së zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë;

dh) informon Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, komandantët e forcave, komandantët e komandave mbështetëse dhe komandantët e njësisve ushtarake për çështje të zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë në fushën e mbrojtjes, sipas fushës së tyre të përgjegjësi;

e) raporton te Ministri i Mbrojtjes për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

ë) i propozon Ministrit të Mbrojtjes krijimin e qendrave të inteligjencës, duke vënë në dijeni më parë Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;

f) propozon tabelën e organizimit dhe pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

g) emëron, liron ose shkarkon nga detyra, komandon punonjës in ushtarak nënoficer dhe ushtar dhe punonjës in civil, ekuivalent me punonjës in ushtarak, nënoficer dhe

ushtar, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

gj) nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit dy ose shumëpalëshe me strukturat e inteligjencës brenda dhe jashtë vendit, me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes;

h) nxjerr urdhra dhe udhëzime të karakterit ushtarako-administrativ brenda kompetencave të tij;

i) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 11

Kriteret për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet personi që, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 31, të këtij ligji, plotëson edhe këto kriterë:

a) të ketë shërbyer për një periudhë kohore jo më pak se 15 vjet në struktura të inteligjencës ushtarake apo në institucione me natyrë të ngjashme me to, nga të cilat jo më pak se 10 vjet në pozicione drejtuese;

b) të ketë kryer ciklin e parë të studimeve të larta ose ciklin e dytë të studimeve të larta në fushën e inteligjencës ose sigurisë;

c) të ketë kualifikime në fushën e inteligjencës ose sigurisë.

Neni 12

Zëvendësdirjtorët e përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Zëvendësdirjtorët e përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra nga Ministri i Mbrojtjes.

2. Zëvendësdirjtorët e përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë ushtarakë aktivë ose civilë.

3. Në çdo rast, një nga zëvendësdirjtorët e përgjithshëm është civil.

4. Në rast të mungesës së Drejtorit të Përgjithshëm, ai zëvendësohet nga njëri prej zëvendësdirjtorëve të përgjithshëm.

Neni 13

Kriteret për emërimin e zëvendësdirjtorit të përgjithshëm

Zëvendësdirjtor i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emërohet personi që, përveç kriterëve të përcaktuara në nenin 31, të këtij ligji, plotëson edhe këto kriterë:

a) të ketë shërbyer për një periudhë jo më pak se 10 vjet në struktura të inteligjencës ushtarake ose civile apo në institucione me natyrë të ngjashme me to, nga të cilat jo më pak se 6 vjet në pozicione drejtuese;

b) të ketë kryer ciklin e parë të studimeve të larta ose ciklin e dytë të studimeve të larta në fushën e inteligjencës ose sigurisë;

c) të ketë kualifikime në fushën e inteligjencës ose sigurisë.

Neni 14

Lirimi ose shkarkimi nga detyra i Drejtorit të Përgjithshëm dhe i zëvendësdirjtorit të përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm ose zëvendësdirjtor i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes lirohet nga detyra nga autoriteti që e ka emëruar, nëse:

a) plotëson moshën për pension të plotë pleqërie;

b) del në rezervë ose lirim nga shërbimi ushtarak;

c) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj;

ç) emërohet në një detyrë tjetër.

2. Drejtori i Përgjithshëm ose zëvendësdirjtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes shkarkohet nga detyra nga autoriteti që e ka emëruar, nëse:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

b) nuk ushtron detyrën në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) kryen akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij.

KREU III

VEPRIMTARIA E AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 15

Marrëdhëniet e bashkëpunimit

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bashkëpunon në fusha me interes reciprok, me institucione homologe dhe partnere të inteligjencës dhe sigurisë, të huaja dhe të vendit, si dhe me institucione brenda vendit, duke lidhur marrëveshje dy ose shumëpalëshe.

2. Përparësitë, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit miratohen nga Ministri i Mbrojtjes, në përputhje me politikën shtetërore, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 16

Qendrat e inteligjencës

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, krijon qendra inteligjence që funksionojnë jashtë vendit në mënyrë të përkohshme, në zona përgjegjësie dhe zona interesi ku kryhen misione dhe operacione ushtarake në mbështetje të Forcave të Armatosura.

2. Qendrat e inteligjencës krijohen me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes.

3. Procedurat e funksionimit të qendrës së inteligjencës përcaktohen me rregullore të miratuar nga ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 17

Burimet e informacionit

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në përmbushje të misionit të saj, përdor dhe shfrytëzon për grumbullim informacioni:

- a) burime njerëzore;
- b) burime sinjalore;
- c) burimet e hapura;
- ç) burime hartografike dhe fotografike.

2. Burimet sinjalore të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes grumbullojnë informacion vetëm me natyrë zbulimi jashtë vendit.

Neni 18

Grumbullimi i informacionit

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, siguron informacionin e nevojshëm nëpërmjet:

- a) bashkëpunimit me individë me vullnetin e tyre të lirë;
- b) përdorimit të mbikëqyrjes së fshehtë;
- c) krijimit dhe përdorimit të evidencës operative;
- ç) përdorimit të mjeteve teknike dhe elektronike;
- d) përgjimeve të telekomunikimeve;
- dh) kontrollit postar.

2. Procedurat specifike lidhur me shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 1, të këtij neni, miratohen me rregullore të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm, të propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Mënyra e përdorimit të procedurave specifike përcaktohet me hollësi në rregulloren e linjës informative që miratohet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

4. Përgjimi i telekomunikimeve dhe kontrolli postar për sigurimin e informacionit të nevojshëm bëhet sipas legjislacionit në fuqi për përgjimin e telekomunikimeve.

Neni 19

Përdorimi i identitetit të dyfishtë

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ose individ që merr pjesë në operacione të fshehta të kësaj Agjencie mund të përdorë identitet të dyfishtë, në mënyrë të përkohshme, me qëllim garantimin e sigurisë së operacionit.

2. Procedurat për pajisjen, mbajtjen dhe përdorimin e identitetit të dyfishtë përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Kur individit ose punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, që merr pjesë në operacione të fshehta dhe përdor identitet të dyfishtë, për shkak të detyrës ose bashkëpunimit, i kërcënohet jeta, shëndeti, familja apo prona, i garantohet mbrojtje e veçantë ligjore me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

4. Mënyrat dhe kriteret e mbrojtjes së veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 20

Burimet financiare

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka dhe përdor buxhetin e vet, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Aktet ligjore e nënligjore në fuqi për përdorimin dhe kontrollin e fondeve publike nuk zbatohen për veprimtari specifike operative të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Përdorimi dhe kontrolli i fondeve për veprimtari specifike operative përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 21

Ndalimi i veprimtarisë policore

Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprimtari të karakterit policor.

Neni 22

Ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit

Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet të kryejë veprime për të realizuar qëllime e objektiva që nuk kanë lidhje me misionin e saj.

Neni 23

Informacionet

1. Informacionet e grumbulluara nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk përbëjnë bazë ligjore për kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si dhe të interesave të personave fizikë e juridikë.

2. Ndalohet përdorimi i informacioneve të përfuara nga veprimtaria informative e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për qëllime përfitimi vetjak apo qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 24

Ruajtja e informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i përftuar nga veprimtaria informative e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë informacionin e klasifikuar gjatë dhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Personi që, për shkak të detyrës, është njohur me informacionin e klasifikuar të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ka për detyrë ta mbrojë atë në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

4. Për rastet e shkeljes së detyrimit të përmendur në pikën 2, të këtij neni, kur nuk përbën vepër penale, ndaj personave përgjegjës merren masa disiplinore, sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 25

Përfshirja nga publikimi

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ndalohej të japë informacion që ka të bëjë me të dhëna të klasifikuara dhe përfshirë nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të të dhënave, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, si dhe të numrit të punonjësve të kësaj Agjencie.

2. Autoritetet, subjektet dhe individët që njihen me informacione të përfuara nga veprimtaria e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, e kanë të ndaluar, për çdo lloj motivi, dhënien, keqpërdorimin apo bërjen publike të tyre.

Neni 26

Mbikëqyrja dhe kontrolli

1. Ndaj Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ushtrohet mbikëqyrje parlamentare, kontroll administrativ, financiar dhe ligjor në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi.

2. Autoritetet që ushtrojnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë:

a) Kuvendi, i cili ushtron mbikëqyrje parlamentare mbi veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

b) Kryeministri, i cili ushtron kontroll mbi veprimtarinë, si dhe kontroll financiar në programimin dhe përdorimin e fondit specifik operativ të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

c) Ministri i Mbrojtjes, i cili ushtron kontroll të drejtpërdrejtë dhe të plotë administrativ, financiar dhe operacional mbi veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

ç) Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i cili ushtron kontroll për veprimtarinë e kësaj Agjencie personalisht ose nëpërmjet punonjësve të autorizuar prej tij.

3. Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i autorizuar prej tij, raporton për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në komisionin apo nënkomisionin përgjegjës parlamentar, lidhur me çështjet e sigurisë dhe të inteligjencës, të paktën një herë në vit, si dhe sa herë që kërkohet prej tyre.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i paraqet, çdo vit, Ministrin të Mbrojtjes raport për veprimtarinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara.

5. Mbikëqyrja, kontrolli i ushtruar dhe raportimet e bëra nga autoritetet e sipërpërmendura kryhen duke ruajtur burimet dhe informacionet e klasifikuara, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

STATUSI I PUNONJËSIT TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 27

Fitimi dhe humbja e statusit

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes gëzon status të veçantë, sipas këtij ligji.

2. Këtë status e fiton:

a) punonjësi ushtarak dhe civili Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në detyrë;

b) punonjësi në rezervë, në lirim ose në pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përveç të drejtave dhe detyrimeve që ka, sipas këtij ligji, ka dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për ushtarakun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes e humbet statusin në rastet kur:

a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

b) ndërpret marrëdhëniet e punës me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pa shkaqe ligjore.

Neni 28

Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është vetëm shtetasi shqiptar, ushtarak ose civil, që shërben në strukturat e kësaj agjencie.

2. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për përparimin në gradë, karrierë dhe daljen në rezervë apo lirim nga shërbimi ushtarak trajtohet sipas legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Punonjësit civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përbëjnë jo më shumë se 40 për qind të numrit të përgjithshëm të punonjësve të kësaj Agjencie.

4. Detyrat funksionale dhe përshkrimet e vendit të punës së punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përcaktohen dhe miratohen me rregullore nga Drejtori i Përgjithshëm.

5. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes duhet të kryejë kursin bazë në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit. Kursi bazë në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit organizohet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 29

Klasifikimi i funksioneve

1. Funksionet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes klasifikohen, si më poshtë:

- a) funksion i nivelit të lartë drejtues;
- b) funksion i nivelit të mesëm drejtues;
- c) funksion i nivelit të ulët drejtues;
- ç) funksion i nivelit ekzekutues;
- d) funksion i nivelit mbështetës.

2. Funksion i nivelit të lartë drejtues është Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Funksione të nivelit të mesëm drejtues janë:

- a) zëvendësdrejtor i përgjithshëm;
- b) drejtor drejtorie.

4. Funksion i nivelit të ulët drejtues është përgjegjës sektori.

5. Funksione të nivelit ekzekutues janë:

- a) specialist;
- b) analist;
- c) inspektor.

6. Funksion i nivelit mbështetës është ndihmësinsektor.

Neni 30

Kriteret e pranimit

1. Për t'u pranuar në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ushtaraku ose civili ekuivalent duhet të plotësojë këto kriteret të përgjithshme:

- a) të jetë vetëm shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor;
- ç) të ketë gradën për vendin përkatës të punës;
- d) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- dh) të mos jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- e) të mos jetë larguar për shkelje disiplinore nga administrata publike;
- ë) të plotësojë kushtin e sigurisë;
- f) të mos ketë filluar ndjekja penale ndaj tij;
- g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të detyrës në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- gj) të mos ketë konflikt interesi me detyrën ose funksionin që do të kryejë.

h) të ketë qëndrim jo më pak se 5 vitet e fundit në Shqipëri, përjashtuar personin që është dërguar jashtë shtetit në përfaqësi ose mision ushtarak apo diplomatik, si dhe për studime nga Ministria e Mbrojtjes ose nga institucione të tjera shtetërore, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre çështje të sigurisë ose të mbrojtjes.

2. Personat që punësohen në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, krahas kërkesave të përgjithshme, duhet të plotësojnë kushtin e sigurisë dhe disa kriteret të veçanta, për raste e për profesione specifike.

3. Verifikimi i kushtit të sigurisë zbatohet ndaj personit që kërkon të punësohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, si dhe për lidhjet e tij me personat e familjes ose jashtë saj. Personat që nuk plotësojnë kushtin e sigurisë nuk mund të lidhin ose të kenë marrëdhënie pune me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

4. Kriteret për plotësimin e kushtit të sigurisë përcaktohen me rregullore, të miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 31

Procedura e pranimit të punonjësit

1. Punonjësi ushtarak që do të pranohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përzgjidhet nga ushtarakët e Forcave të Armatosura, sipas kriterëve të arsimimit, kualifikimit dhe kriterëve të vendit të punës, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. Pranimi i punonjësve civilë në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhet me konkurrim.

3. Shpallja e vendit të lirë të punës bëhet nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në dy gazeta me qarkullim të madh kombëtar, të paktën, 30 ditë para datës së caktuar për konkurrim. Shpallja përmban vetëm kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati, ndërsa njoftimi për specialitetin, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi, kryhet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

4. Pranimi në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në raste të veçanta, mund të kryhet pa konkurrim, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

5. Rastet e veçanta dhe profesionet specifike përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 32

Komisioni i testimit

1. Komisioni i testimit në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes zhvillon testimin e ushtarakëve ose civilëve që do të pranohen në këtë agjenci, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore, si dhe pas kryerjes së procesit të plotësimit të kushtit të sigurisë nga struktura përgjegjëse e sigurisë.

2. Komisioni i testimit përzgjedh ushtarakun ose civilin që do të punësohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pasi ka kryer:

- a) testimin me shkrim;
- b) intervistën me gojë.

3. Komisioni i testimit ngrihet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Procedurat dhe rregullat e funksionimit të komisionit të testimit përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 33

Periudha e provës

1. Punonjësi, ushtarak dhe civil, që pranohet të punësohet në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i nënshtrohet një periudhe prove prej 6 muajsh, e cila fillon nga data e emërimit. Gjatë kësaj periudhe punonjësi është nën kujdesin e eprorit të tij dhe vlerësohet nga ky i fundit. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe punonjësi duhet të kryejë kursin bazë në qendrën e trajnimit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Në fund të periudhës së provës, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i propozon Ministrit të Mbrojtjes për punonjësin ushtarak dhe civil në kompetencë të tij:

a) emërimin në detyrë si punonjës i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë;

c) lirimimin ose shkarkimin nga detyra.

3. Në fund të periudhës së provës, eprori i drejtpërdrejtë i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për punonjësin civil në kompetencë të tij:

a) emërimin në detyrë si punonjës i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë;

c) lirimimin ose shkarkimin nga detyra.

4. Punonjësi në periudhë prove gëzon të drejtat dhe detyrimet e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 34

Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit

1. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit ushtarak oficer ose i punonjësit civil ekuivalent me të, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Emërimi, lirimi ose shkarkimi nga detyra i punonjësit ushtarak nënoficer, ushtar, ose i punonjësit civil ekuivalent me ta, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve, bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me propozim të komisionit të testimit.

Neni 35

Vjetërsia në punë, për efekt pensioni të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

Vjetërsi në punë e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për efekt pensioni të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, njihet:

a) koha nga data e pranimin deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;

b) koha e punës në struktura të tjera që përfitojnë sigurime shoqërore suplementare;

c) koha e ndërprerjes së karrierës në shërbim, për shkak të një vendimi të padrejtë, të cilësuar si të tillë nga gjykata.

Neni 36

Vlerësimi i punës

1. Vlerësimi i punës së punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhet një herë në vit, si dhe në rastet e mbarimit të periudhës së provës.

2. Procedurat e vlerësimit për punonjësin civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

3. Shkallët e vlerësimit për punonjësin civil janë:

- a) “shumë mirë”;
- b) “mirë”;
- c) “mjaftueshëm”;
- ç) “jo mjaftueshëm”.

4. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vlerësohet sipas procedurave të vlerësimit që aplikohen për ushtarakun e Forcave të Armatosura.

Neni 37

Karriera dhe ngritja në detyrë e punonjësit civil

1. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përparon në karrierë dhe mund të ngrihet në detyrë në një pozicion të një niveli më të lartë, kur një vend i tillë ekziston, në bazë të meritave e përvojës në punë dhe kur vlerësimet për punën e kryer janë në shkallën “shumë mirë”.

2. Punonjësi që ka masë disiplinore të pashlyer nuk mund të ngrihet në detyrë.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për të përparuar në karrierë dhe për t’u ngritur në detyrë në një pozicion të një niveli më të lartë, duhet të ketë këtë përvojë pune:

- a) jo më pak se 3 vjet, kur është punonjës në funksion ekzekutues;
- b) jo më pak se 5 vjet, kur është drejtues i nivelit të ulët;
- c) jo më pak se 10 vjet, kur është drejtues i nivelit të mesëm, drejtor drejtorie, në struktura të inteligjencës ushtarake ose civile apo në institucione me natyrë të ngjashme me to.

Neni 38

Komandimi

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, oficer dhe civil, ekuivalent sipas tabelës së orgaizimit e pajisjeve, për nevoja pune, mund të komandohet në një detyrë tjetër, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, për një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, nënoficer, ushtar dhe civil, ekuivalent me ta sipas tabelës së organizimit e pajisjeve, për nevoja pune, mund të komandohet në një detyrë tjetër, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie për një periudhë jo më shumë se 6 muaj.

3. Gjatë kohës së komandimit, punonjësit i ruhet vendi i punës dhe trajtohet me pagën e vendit të punës që ka pasur para komandimit.

Neni 39

Pezullimi i punonjësit

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve të punës, për sa kohë zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në përfundim të periudhës së pezullimit punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel me detyrën e mëparshme, me përjashtim të rastit kur dënohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

2. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pezullohet nga detyra sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura.

3. Pezullimi i punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes bëhet me urdhër të autoritetit që e ka emëruar, në rastet kur:

- a) ndaj tij fillon ndjekja penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata;
- b) ndjek studimet me nismën e vet, për më shumë se 6 muaj, dhe në lidhje me profesionin që ai ushtron. Periudha e studimeve nuk mund të jetë më shumë se 2 vjet.

4. Gjatë periudhës së pezullimit punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk paguhet. Në rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij neni, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm, punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i jepet paga bazë që nga momenti i pezullimit.

Neni 40

Lirimi ose shkarkimi nga detyra

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, oficer ose civil ekuivalent, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, nënoficer, ushtar ose civil ekuivalent, lirohet ose shkarkohet nga detyra me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën për pension të plotë pleqërie;
- c) bëhet i paaftë përgjithmonë për kryerjen e detyrave, për shkak të kushteve shëndetësore;
- ç) nuk mund të ushtrojë detyrën për një periudhë kohore më të gjatë se 6 muaj për pamundësi fizike dhe shëndetësore;
- d) ka ristrukturim ose shkurtrim funksioni organik;
- dh) vlerësohet dy herë rresht “jo mjaftueshëm”;

- e) nuk pranon të emërohet në një detyrë tjetër;
- ë) përfundon kontratën e punës;
- f) ka konflikt interesi me detyrën që kryen;
- g) nuk pajiset ose i hiqet “certifikata e sigurisë”.

4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes shkarkohet nga detyra në rastet kur:

- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) për shkelje të rënda disiplinore;
- c) për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij dhe të institucionit.

5. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nxirret në rezervë apo lirim nga shërbimi ushtarak, sipas legjislacionit në fuqi për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në momentin që lirohet ose shkarkohet nga detyra, dorëzon menjëherë detyrën.

KREU V

DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E PUNONJËSIT TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Neni 41

Detyrat kryesore

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka këto detyra kryesore:

a) të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

b) të ushtrojë me përkushtim detyrën dhe të veprojë me profesionalizëm e me përgjegjësi;

c) të jetë i paanshëm, objektiv dhe i drejtë;

ç) të mos niset nga interesi i përfitimit personal e të mos krijojë favore për individë të caktuar, duke u kushtëzuar nga motive që nuk lidhen me realizimin me ndërgjegje të detyrës;

d) të realizojë me besnikëri detyrat e funksionet zyrtare, pavarësisht nga pikëpamja personale dhe të zbatojë me përpikëri urdhrat ose vendimet e organeve eprore;

dh) të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e mosveprimet e veta, gjatë ushtrimit të detyrës dhe, kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhrave e të vendimeve, të vërë në dijeni menjëherë urdhërdhënësin dhe eprorët e këtij të fundit;

e) të zbatojë rregullat e etikës së administratës publike.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të kryejë të gjitha detyrat për të cilat është ngarkuar.

Neni 42

Përgjegjësia e punonjësit

Për shkeljen e akteve ligjore e nënligjore të disiplinës në punë dhe për dëme materiale të pronës publike ose private, punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes mban përgjegjësi penale, administrative, materiale apo civile, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 43

Ruajtja e dinjitetit

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë dinjitetin dhe integritetin e institucionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

2. Paraqitja në publik, komunikimi dhe veprimet e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përfaqësojnë autoritetin e institucionit.

Neni 44

Asnjënia politike

1. Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtaritë e partive apo organizatave politike dhe joqeveritare, si dhe kryerja e veprimtarive në favor ose kundër partive, shoqatave politike apo kandidatëve në zgjedhje.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk duhet të manifestojë sjellje dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të institucionit.

Neni 45

Kufizimi i së drejtës së grevës

Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes nuk ka të drejtë të bëjë grevë, si dhe të bëjë kërkesa e ankesa kolektive.

Neni 46

Ruajtja e aktiveve

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është i detyruar të ruajë e të mirëmbajë mjediset e punës dhe mjetet e dhëna në përdorim për kryerjen e detyrës.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përgjigjet për dëmin që u shkakton, me dashje apo nga pakujdesia, aktiveve të agjencisë. Në këtë rast, brenda 6 muajve nga data e zbulimit të dëmit, por jo më vonë se 3 vjet nga data e shkakimit të dëmit, nxirret urdhri i zhdëmtimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Kundër urdhrat të zhdëmtimit punonjësi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Neni 47

Dëmi i shkaktuar të tretëve

1. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar nga punonjësi i kësaj agjencie, gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj ndaj personave fizikë e juridikë.

2. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas rrethanave, kërkon nga punonjësi përgjegjës për dëmin e shkaktuar shpenzimet e zhdëmtimit.

3. Për përgjegjësinë e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përgjegjësinë vetjake të punonjësve të saj, rastet e shkaktimit të dëmit ndaj personave fizikë e juridikë, privatë, si dhe dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore.

Neni 48

Kufizimi i lirisë së lëvizjes

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ka të drejtë të dalë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me leje me shkrim të Ministrit të Mbrojtjes ose personit të autorizuar prej tij.

2. Procedurat dhe rregullat për dhënien e lejeve për punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përcaktohen me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

Neni 49

Paga dhe shtesat mbi pagë

1. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes trajtohet me pagë si ushtarakët e Forcave të Armatosura.

2. Paga mujore e punonjësit civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është sipas legjislacionit në fuqi që përcakton pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese e institucioneve të tjera, të pavarura, të krijuara me ligj, si institucion qendror në varësi të ministrisë së linjës.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes trajtohet për natyrë të veçantë pune dhe vështirësi shërbimi, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 50

Sigurimet shoqërore suplementare

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përveç përfitimeve që rrjedhin nga legjislacioni për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera shtesë, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin përkatës për sigurimet shoqërore suplementare.

2. Për efekt të përfitimit të sigurimeve shoqërore suplementare, si vjetërsi shërbimi njihet periudha nga momenti i emërimit deri në momentin e lirimit ose shkarkimit nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 51

Kohëzgjatja e punës

1. Kohëzgjatja normale e punës për punonjësën e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes njësohet me atë të punonjësve të administratës publike.

2. Për nevoja të punës dhe interesa të shërbimit, koha e punës mund të zgjatet tej kohës normale me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes ose të eprorit të punonjësit. Në këto raste, punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 52

Kohëzgjatja e pushimit

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes gëzon të drejtën e pushimit javor, të pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

2. Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për punonjësën ushtarak dhe civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes është 45 ditë kalendarike.

3. Kur pushimi vjetor për punonjësën e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për arsye pune ose shërbimi, nuk jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se në muajin mars të vitit pasardhës, në të kundërt paguhet për lejen e pakryer.

4. Kur punonjësi, gjatë kryerjes së lejes së pagueshme vjetore, për arsye shëndetësore bëhet i paafte për punë, e vërtetuar kjo me raport mjekësor, ai njofton Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.

5. Në rast të martesës së tij ose të pjesëtarëve të familjes apo në rast fatkeqësie familjare ose sëmundjeje të rëndë të pjesëtarëve të familjes dhe në raste të tjera të ngjashme me to, punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie i jepen deri në 5 ditë leje të pagueshme ose deri në 45 ditë leje pa të drejtë page.

Neni 53

Dokumentit i identifikimit dhe armatimi

1. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes pajiset me dokument zyrtar identifikimi.

2. Forma e dokumentit të identifikimit miratohet nga Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

3. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas funksioneve të veçanta, të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i kësaj Agjencie, pajiset me armatim personal, të cilin e mban dhe e përdor në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

4. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, kur ndërpret marrëdhëniet e punës, dorëzon menjëherë dokumentin e identifikimit dhe armatimin përkatës.

5. Kur punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vdes, familjarët e tij dorëzojnë dokumentin e identifikimit dhe armatimin e tij, brenda 30 ditëve, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

Neni 54 **Uniforma**

1. Punonjësi ushtarak i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në varësi të natyrës së detyrës ose operacioneve, mban uniformë ushtarake a veshje civile.

2. Punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes trajtohet me veshmbathje në vlerë leku, një herë në vit, në masën e gjysmës së pagës mujore të vendit të punës.

Neni 55 **Mbrojtja e veçantë ligjore**

1. Kur punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, për shkak të ushtrimit të detyrës, i kërcënohet jeta, shëndeti, familja apo prona, i garantohet mbrojtje e veçantë ligjore me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të kësaj Agjencie.

2. Mënyrat dhe kriteret e mbrojtjes së veçantë ligjore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

KREU VI **MBROJTJA SHOQËRORE PËR PUNONJËSIN CIVILTË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES**

Neni 56

Trajtimi i familjarëve të personit që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj

1. Familja e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, që humbet jetën në detyrë ose për shkak të saj, si dhe familja e personit që ka krijuar marrëdhënie bashkëpunimi të fshehtë me këtë agjenci dhe humbet jetën për shkak të këtij bashkëpunimi, përfiton kompensim të veçantë.

2. Kriteret dhe masa e përfitimit të kompensimit, për shkak të humbjes së jetës në detyrë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57 **Mbështetja arsimore**

Fëmijët e punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, që ka humbur jetën në detyrë ose për shkak të saj, kur fitojnë të drejtën e ndjekjes së studimeve në institucionet publike shtetërore të arsimit të lartë brenda vendit, përfitojnë nga shteti bursë të plotë, brenda kuotave të përgjithshme të pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, për vitin akademik përkatës.

Neni 58 **Ndihma financiare në raste vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie**

1. Kur punonjësi i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vdes, sëmuret rëndë e për një kohë të gjatë, të vërtetuar me raport mjekësor, ose pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, familjes ose atij i jepet ndihmë financiare e menjëhershme, në masën deri në 6 paga mujore.

2. Punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes i jepet ndihmë financiare e menjëhershme, në masën deri në 3 paga mujore, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij është i sëmurë rëndë dhe për një kohë të gjatë ose vdes.

3. Kur punonjësi në detyrë i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes vdes, kjo agjenci organizon ceremoninë e rastit dhe përballon shpenzimet e varrimit.

4. Kriteret dhe masa e përfitimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

KREU VII **DISIPLINA PËR PUNONJËSIT CIVILË TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES**

Neni 59 **Disiplina**

1. Punonjësve civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes u jepen masa disiplinore për mosplotësimin e detyrave, për thyerje të disiplinës në punë e të rregullave të etikës, për shkelje të akteve ligjore e nënligjore, si dhe për raste të tjera të parashikuara nga ky ligj.

2. Masat disiplinore jepen sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, miraton rregulloren e disiplinës për punonjësit civilë, kërkesat e së cilës janë të detyrueshme për zbatim.

3. Masat disiplinore jepen për punonjës civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, kur veprimet dhe mosveprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale.

4. Për punonjës ushtarak të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes zbatohet legjislacioni në fuqi për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 60

Llojet e masave disiplinore

Llojet e masave disiplinore për punonjës civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) kalim në një detyrë të një niveli ose klase më të ulët për një periudhë deri në një vit;
- ç) lirim ose shkarkim nga detyra.

Neni 61

Dhënia e masës disiplinore dhe shlyerja e saj për punonjës civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

1. Procedimi disiplinor për punonjës civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes fillon jo më vonë se 30 ditë nga çasti i konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se një vit nga çasti i kryerjes së saj.

2. Nismën për fillimin e procedimit disiplinor e ndërmerret eprori direkt i punonjësit të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, i cili i propozon Drejtorit të Përgjithshëm fillimin e ecurisë disiplinore. Drejtori i Përgjithshëm vendos për ngritjen e komisionit disiplinor. Komisioni disiplinor, pasi njihet me dokumentacionin dhe faktet për shkeljen e pretenduar, i propozon Ministrit të Mbrojtjes ose Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas përkatësisë së emërimit të punonjësit, dhënien e masës disiplinore ose pushimin e çështjes. Pas propozimit të komisionit disiplinor, Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, vendos dhënien, mosdhënien ose ndryshimin e masës.

3. Masat disiplinore jepen në mënyrë të shkallëzuar ose sipas rëndësisë së shkeljes dhe të pasojave. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

4. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i komunikohet, me shkrim, të interesuarit.

5. Masat e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji, me përjashtim të masave të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të tij, shlyhen, nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre ndaj personit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.

Neni 62

Njohja me dokumentacionin e procedimit

1. Punonjës civil të proceduar i jepet dokumentacioni i procedimit të nisur në ngarkim të tij 3 ditë para shqyrtimit të shkeljes nga komisioni disiplinor, për të pasur mundësi për të përgatitur mbrojtjen.

2. Punonjës civil i proceduar njoftohet për datën kur do të shqyrtohen materialet që lidhen me të, jo më vonë se 5 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit për përgatitjen e mbrojtjes.

Neni 63

E drejta për t'u dëgjuar

1. Punonjës civil, ndaj të cilit ka nisur procedimi disiplinor, ka të drejtë të mbrohet, duke u paraqitur vetë para komisionit disiplinor, i cili është i detyruar ta dëgjojë dhe të verifikojë pretendimet e ngritura.

2. Mosparaqitja, pa shkaqe të arsyeshme, e punonjës civil të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në seancën dëgjimore nuk e pengon komisionin disiplinor të shqyrtojë çështjen dhe të nxjerrë përfundimet përkatëse.

Neni 64

Marrja e masës disiplinore

Komisioni disiplinor shprehet brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së pretendimeve nga punonjës civil i proceduar disiplinarisht.

Neni 65

Ankimi

1. Punonjës civil ka të drejtë të ankohet te Ministri i Mbrojtjes, kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm për dhënien e masës disiplinore, sipas shkronjës “ç”, të nenit 60, të këtij ligji, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të saj. Ministri i Mbrojtjes vendos lënien në fuqi, mosdhënien ose ndryshimin e masës.

2. Punonjës civil, të cilit i është dhënë masë disiplinore, sipas shkronjës “ç”, të nenit 60, të këtij ligji, nga Ministri i Mbrojtjes ose Drejtori i Përgjithshëm, ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga njoftimi.

KREU VIII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 66

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve:

a) Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 6, pika 2; 19, pika 4; 20, pika 3; 49, pika 3; 55, pika 2, dhe 58, pika 4, të këtij ligji;

b) Kryeministri, në zbatim të nenit 6, pika 4, të këtij ligji;

c) Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të neneve 8, pika 3, shkronja “gj”; 16, pika 3; 18, pika 2; 19, pika 2; 30, pika 4, 31, pika 5; 32, pika 3; 36, pika 2; 48, pika 2; 53, pika 2; dhe 59, pika 2, të këtij ligji.

Neni 67
Shfuqizime

Ligji nr. 117/2012, “Për Agjencinë e Inteligjencës së Mbrojtjes”, miratuar në datën 13.12.2012, shfuqizohet.

Neni 68
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2014

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 66/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 8488, DATË 13.5.1999, “PËR MBROJTJEN E
TOPOGRAFISË SË QARQEVE
TË INTEGRUARA”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8488, datë 13.5.1999, “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në titullin e ligjit dhe në nenet 1, 2, 9, 10, 12 dhe 16, fjalët “qarkut të integruar” zëvendësohen me fjalët “produkt gjysmëpërçues”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen si më poshtë:

“a) “një produkt gjysmëpërçues” është forma përfundimtare ose e ndërmjetme e një produkti, i cili plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me direktivën 87/54/KEE, të Këshillit, datë 16 dhjetor 1986 “Mbi mbrojtjen ligjore të topografisë së produkteve gjysmëpërçuese”. Numri CELEX: 31987L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 24, datë 27.1.1987, faqe 36-40.

i) përbëhet nga një masë materiali, e cila përfshin një shtresë materiali gjysmëpërçues;

ii) ka një ose më shumë shtresa të tjera që përbëhen nga material përcjellës, izolues apo gjysmëpërçues, të cilat vendosen sipas një modeli të paracaktuar tredimensional;

iii) ka për qëllim të kryejë, vetëm ose së bashku me funksionet e tjera, një funksion elektronik;

b) “topografia e një produkti gjysmëpërçues” është një seri imazhesh të lidhura, pavarësisht nga mënyra e fiksimit apo kodimit të tyre:

i) të cilat përfaqësojnë modelin tredimensional të shtresave, nga të cilat përbëhet një produkt gjysmëpërçues;

ii) ku në secilën seri, çdo imazh ka modelin ose një pjesë të modelit të sipërfaqes së produktit gjysmëpërçues në çdo fazë të prodhimit të tij.”.

2. Në fund të shkronjës “c” shtohen fjalët “ose çdo ofertë për këtë qëllim”.

Neni 3

Në nenin 3, pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Të drejtën e mbrojtjes e gëzojnë, gjithashtu, edhe trashëgimtarët e personave të përmendur në paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni.”.

Neni 4

Në nenin 9, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“E drejta ekskluzive për të autorizuar apo ndaluar ndonjë prej veprimeve të parashikuara në shkronjën “b”, të paragrafit të parë, të këtij neni, nuk zbatohet për veprimet e kryera, pasi topografia ose produkti gjysmëpërçues është hedhur në treg në Republikën e Shqipërisë nga personi që ka të drejtën të autorizojë tregtimin e saj ose me pëlqimin e tij.”.

Neni 5

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e parë, e paragrafit të dytë, ndryshohet si më poshtë:

“Të drejtat ekskluzive për pronarin e topografisë së mbrojtur lindin në njëërën prej datave të mëposhtme, cilado është më e hershmja.”.

2. Fjalja e parë, e paragrafit të tretë, ndryshohet si më poshtë:

“Të drejtat ekskluzive mbarojnë me kalimin e 10 vjetëve nga njëra prej datave të mëposhtme, cilado është më e hershmja.”.

3. Pas paragrafit të katërt shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Pa cenuar mjetet juridike në dispozicion për të zbatuar të drejtat ekskluzive që burojnë nga neni 9, personi që gëzon të drejtën e mbrojtjes dhe që provon se një person tjetër me mashtrim ka riprodhuar, shfrytëzuar në treg ose importuar për këtë qëllim një topografi, ka të drejtë t'i

kërkojë gjykatës të parandalojë shkeljen, si dhe shpërblimin e dëmit për periudhën para se ato të drejta të lindin.”.

4. Paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:

“Në qoftë se një topografi nuk është shfrytëzuar për qëllime tregtare askund në botë, të drejtat ekskluzive shfuqizohen 15 vjet pas datës së fiksimit apo kodimit. Një e drejtë e re ekskluzive mund të lindë vetëm pas depozitimit, brenda kësaj periudhe, të një kërkesë për regjistrim në formën e kërkuar nga ky ligj.”.

Neni 6

Në fund të nenit 12 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Materiali i depozituar në përputhje me kërkesat e këtij ligji nuk vihet në dispozicion për publikun, kur ai është sekret tregtar. Kjo dispozitë nuk cenon zbulimin e këtij materiali, në zbatim të një urdhri nga një gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, ndaj personave të përfshirë në çështje gjyqësore, lidhur me vlefshmërinë ose shkeljen e të drejtave ekskluzive të përmendura në nenin 9.”.

Neni 7

Në nenin 15, shkronja “a”, paragrafi i tretë, pas fjalës “qëllime” shtohet fjala “private”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.6.2014

Shpallur me dekretin nr. 8635, datë 18.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

**VENDIM
Nr. 49/2014**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 2/2014,
DATË 30.1.2014, “PËR MIRATIMIN E
PËRBËRJES SË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR
REFORMËN ADMINISTRATIVO-
TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 24, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të PDIU-së,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Në përbërjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë shtohet:

1. Shpëtim Idrizi PDIU (anëtar).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 17.7.2014

**KRYETARI
Ilir Meta**

**VENDIM
Nr. 50/2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 48/2013, “PËR CAKTIMIN E
PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, neneve 55, pika 1, dhe 21, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputetja Luiza Xhuvani caktohet anëtare në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 17.7.2014

**KRYETARI
Ilir Meta**

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË VJETORE
TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE
(AMA) PËR VITIN 2013**

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- AMA ka bërë përpjekje për zbatimin e kërkesave të Kuvendit, të shprehura në rezolutën e vlerësimit të veprimtarisë së saj gjatë vitit 2012.

- Veprimtaria e AMA-s, nga janari deri në fillim të prillit, është realizuar mbi kërkesat e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga prilli në dhjetor, AMA ka funksionuar në zbatim të ligjit të ri nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Kuvendi vlerëson se:

- Ndryshimi pas 15 vjetësh i ligjit që rregullon veprimtarinë e institucionit dhe vakancat e krijuara në përbërjen e anëtarësisë së AMA-s, kanë sjellë një vit të vështirë për punën dhe veprimtarinë e saj.

- AMA, gjatë vitit 2013, në zbatim të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ka miratuar ndryshimin në rregulloren "Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive".

- Ka miratuar ndryshime në rregulloren "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë".

- Gjatë vitit 2013 ndër operatorët radiotelevizivë është vënë re një rritje e sensibilizimit në lidhje me detyrimet që ata kanë për respektimin e të drejtave të transmetimit/autorit. Megjithatë, masat e mara janë shumë pak në krahasim me realitetin. Ky fenomen është bërë gjithnjë e më shumë shqetësues dhe i denoncuar publikisht nga operatorët e cenuar.

- Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe lufta ndaj piraterisë televizive, si detyrim ligjor që rrjedh nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë e mediave elektronike, nuk ka qenë prioritet i punës së AMA-s dhe nuk janë bërë përpjekje maksimale për bashkëpunimin edhe me institucionet e tjera, që operojnë në këtë fushë.

- Me gjithë përpjekjet, AMA nuk ka bërë sa duhet në drejtim të përmbajtjes dhe etikës së programeve audiovizive.

- Gjithnjë më të mprehta dhe shqetësuese kanë qenë shkeljet e së drejtës së privatësisë, keqpërdorimi i gjuhës dhe dhunës në ekran, cenimi i dinjitetit të fëmijëve në programet me dhe për fëmijë, identifikimi i fëmijës dhe viktimave në programet informative dhe të intervistimit, keqpërdorimi i fjalorit dhe gjuhës në disa programe argëtuese dhe transmetimi i filmave dhe programeve pa shenjat paralajmëruese.

- Situata e transmetimeve numerike tokësore vazhdon të jetë krejtësisht e parregulluar, për pasojë, e pakontrolluar.

- Transmetimet analoge vendore pa licencë vazhdojnë punën të pashqetësuar dhe vazhdojnë të transmetojnë si edhe në vitet e shkuara.

- Rregullorja "Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre", nëpërmjet procedurës "beauty contest" ka krijuar pakënaqësi të mëdha nga operatorët në treg, sidomos në mediat historike kombëtare private. Ky proces është i bllokuar.

- AMA ndodhet në një proces të vonuar për miratimin e projektregulloreve shumë të rëndësishme (kërkesë e ligjit) për mirëfunksionimin e tregut të mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

- Përshëndet projektin e iniciuar nga AMA për Kartën e Mbrojtjes së Fëmijëve në Media.

- Nga 19 mbledhje të zhvilluara nga AMA gjatë vitit 2013, në 13 prej tyre nuk është siguruar kuorumi i nevojshëm dhe ato janë zhvilluar në prezencë të një anëtarit pa mandat. Për rrjedhojë, vendimmarrja në to ka qenë e pavlefshme.

- Edhe vetë Kryetarja e AMA-s ka ushtruar funksionet drejtuese, pa qenë anëtare e këtij institucioni që nga 24 shtatori i 2012-s. Për rrjedhojë, pa qenë edhe Kryetare e AMA-s.

Kuvendi kërkon nga AMA:

- Marrjen e masave urgjente për fillimin e zbatimit efektiv në praktikë të strategjisë kombëtare për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike.

- Përgatitjen e akteve të tjera nënligjore për zbatimin e plotë të ligjit të ri për AMA-n.

- Rritjen e bashkëpunimit për plotësimin e vendeve vakante dhe nxjerrjen e institucionit nga ngërçi dhe rivendosjen e tij në shinat e funksionimit normal.

- Rritjen e efikasitetit në luftën kundër fenomenit të piraterisë televizive dhe të së drejtës së autorit.

- Rritjen e forcës kontrolluese dhe parandaluese për rastet e shkeljeve ligjore që vihen re nga operatorët radiotelevizivë.

- Rritjen e bashkëpunimit me shoqatat e gazetarëve dhe organizatat e tjera, për standardet e etikës në programet dhe transmetimet radiotelevizive.

- Shtimin e klimës së besimit dhe të bashkëpunimit me të gjithë operatorët në treg, në përgjithësi, dhe me mediat historike kombëtare private dhe operatorin publik, në veçanti.

- Rritjen e raportit të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese për të koordinuar më mirë punën dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.

- Nxitjen e shtimit të llojshmërisë së tematikës dhe cilësisë së programeve, sipas standardeve më të larta.

- Ndërgjegjësimin, nxitjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të të gjithë aktorëve dhe faktorëve në treg, për realizimin në kohë dhe me cilësi të sfidës dhe detyrimit të kalimit të transmetimeve radiotelevizive, nga analoge në numerike, brenda 17 qershorit 2015.

- Mbajtjen në gatishmëri të Studios së Monitorimeve dhe thellimin e përgatitjes së stafit të saj, për të përballuar kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike.

Miratuar në datën 10.7.2014

KRYETARI
Illir Meta

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESIT PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke konsideruar përparësi kyçe të shtetit dhe Qeverisë Shqiptare luftën kundër korrupsionit, si sfidën kryesore drejt integritetit në BE;

- Duke vlerësuar se ILDKPKI-ja është një institucion me rol thelbësor në zbulimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, pasurive të paligjshme dhe konfliktit të interesit në radhët e funksionarëve të administratës publike, sistemit gjyqësor dhe subjekteve të tjera të ligjit;

- Duke theksuar se integriteti, pavarësia dhe zbatueshmëria e ligjit në mënyrë të paanshme dhe transparente nga ky institucion janë faktorë kryesorë për arritjen e rezultateve të prekshme, sipas pritshmërive të larta të publikut, medias dhe organeve ligjvënëse dhe ligjzbatuese;

- Duke mbështetur kurdoherë veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit në përmirësimin në tërësi të legjislacionit të tij, për forcimin e kapaciteteve administrative dhe instrumenteve ligjore në zbulimin e praktikave të pasurimit korruptiv, si dhe në parandalimin e konfliktit të interesit;

Konstaton për vitin 2013 se ILDKPKI-ja:

- Gjatë vitit 2013 nuk ka asnjë tregues të performancës institucionale si në zbatim të ligjit për deklarimin e pasurisë dhe atij të konfliktit të interesit.

- ILDKPKI-ja nuk ka përmbushur asnjë nga objektivat e pritshëm, të përcaktuar nga vetë ILDKPKI-ja në raportin e punës vjetore për vitin 2013.

- Nuk ka pasur asnjë impakt konkret të amendimeve ligjore të dy ligjeve, përkatësisht ligji nr. 85/2012 dhe ligji nr. 86/2012.

- Nuk ka përfunduar kontrollet për deklarimet e pasurive brenda afateve dhe sipas rregullave të administrimit, skanimit dhe përpunimit dhe hetimit të tyre.

- Nuk ka konkluduar me asnjë kallëzim penal në organin e akuzës dhe nuk ka marrë masa administrative, gjobë, për rastet konkrete.

- Nuk ka tregues të trajtimit, parandalimit dhe sanksionimit të rasteve të konfliktit të interesit.

- Ka pasur një politikë të kufizuar ndërinstitucionale dhe jotransparente me publikun dhe median.

- Nuk ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuëse dhe kanë munguar aktet e nevojshme, si pasojë e legjislacionit të ndryshuar.

- Bazuar në raportin e auditit të Ministrisë së Financave, veprimtaria financiare e ILDKPKI-së gjatë vitit 2013 ka rezultuar me shkelje financiare dhe ligjore, si pasojë e keqmenaxhimit institucional të titullarit në drejtim gjatë vitit 2013.

- Aktiviteti institucional i ILDKPKI-së për gjatë vitit 2013 ka rezultuar në kah të kundërt me objektivat dhe përgjegjësitë ligjore që ky institucion ka si fokus të tijin.

- Kjo performancë negative institucionale ka shkaktuar një situatë serioze të akumulimit të deklaratave dhe volumit të punës së mbartur të pakryer gjatë vitit 2013.

Kuvendi vlerëson dhe inkurajon punën e ILDKPKI-së për të risjellë në nivelet dhe standardet e kërkuara ligjore aktivitetin institucional, me qëllim përmbushjen e të gjitha detyrimeve dhe rekomandimeve që progres-raportet e BE-së dhe raporti i fundit i Komisionit European në muajin qershor 2014, për progresin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, kimit të organizuar dhe reformës në gjyqësor, kanë theksuar për këtë institucion.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2014 kërkon:

1. Marrjen e masave të menjëhershme organizative për të evaduar punën e papërfunduar, të mbartur nga vitet e kaluara, në mënyrë që viti 2015 ta gjejë ILDKPKI-në në parametra normalë.

2. Marrjen e masave për të rikontrolluar dosjet e zyrtarëve, për të cilat ka informacione të besueshme se janë mbyllur në kundërshtim me ligjin.

3. Fillimin e menjëhershëm të punës për të evidentuar se cilat kategori zyrtarësh nuk janë kontrolluar asnjëherë në këto dhjetë vite, duke i futur menjëherë në kontroll të plotë.

4. Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e ndryshimeve të fundit ligjore, lidhur me skemën e kontrollit të plotë të zyrtarëve.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për forcimin e kapaciteteve kontrolluese për konfliktin e interesit në përgjithësi dhe nenit 21, të ligjit nr. 9367, në veçanti, bazuar edhe në ndryshimet e fundit të ligjit për konfliktin e interesave. Shtimi i rasteve të trajtuara të konfliktit të interesit, si dhe krijimi i regjistrit elektronik të rasteve të parandalimit të tyre.

6. Përparsi drejt hetimeve proaktive, veçanërisht hetimet ndaj pasurive të pashpjegueshme, rritjes së rasteve të zbuluara të korrupsionit të nivelit të lartë për të avancuar më tej gjurmimin e rasteve dhe denoncimin e penalizimin e këtyre subjekteve dhe personave të lidhur me ta.

7. Përmirësimi i metodologjisë së kontrolleve të deklarimit të pasurive, analizë e vlerësimit të rrezikut në verifikime të detajuara të aseteve dhe përcaktimi i niveleve të jetesës për të llogaritur balancën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

8. ILDKPKI-ja të sigurojë akses të plotë ndaj të gjitha burimeve të të dhënave publike ose private që janë në disponim në institucionet publike dhe private.

9. Zbatimit korrekt të ligjeve të deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe konfliktit të interesit dhe ndryshimeve ligjore përkatëse, përmes respektimit të ligjshmërisë, barazisë, paanësisë dhe drejtësisë, publicitetit dhe konfidencialitetit, pavarësisë dhe respektimit të parimit të proporcionalitetit.

10. Rritja e transparencës në punën e bërë nga Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, duke orientuar bërjen publike të deklaratave të aseteve të zyrtarëve me kërkesë dhe jo vetëm.

11. Forcimi i mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesave privatë të zyrtarëve brenda dhe jashtë vendit.

12. Intensifikim të raporteve institucionale dhe bashkërendim të politikave me institucionet dhe organizmat antikorrupsion, në veçanti me organin e akuzës, për rritjen cilësore të çështjeve të hetimit, shqyrtimit e gjykimit të veprave korruptive dhe konfliktit të interesit, si dhe me organet e auditimit, për rastet e fitimit të pasurive si rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale.

13. Zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunimin efektiv midis institucioneve dhe në veçanti nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi të re midis ILDKPKI-së dhe KLD-së (marrëveshja e vetme e lidhur që prej vitit 2004).

14. Komunikim intensiv me autoritetet përgjegjëse në institucionet publike për ndryshimet e fundit ligjore.

15. Të sigurojë dhe të rrisë efikasitetin në punën investigative, kontrolluese dhe konkluduese, duke përshtatur strukturën, sipas dinamikës së funksioneve institucionale, në raport edhe me ndryshimet e fundit ligjore.

Miratuar në datën 10.7.2014

**KRYETARI
Ilir Meta**

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË UJIT (ERRU) PËR VITIN 2013

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

- Duke njohur rolin e Entit Rregullator të Ujit në krijimin e një sektori ujësjellës-kanalizimesh financiarisht të qëndrueshëm, që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshëm për të gjithë konsumatorët;

- Duke e konsideruar shumë të rëndësishme mbrojtjen e konsumatorit në drejtim të cilësisë më të mirë të shërbimeve të ofruara nga operatorët në sektor;

- Duke e konsideruar të rëndësishëm vënien në funksionim të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe rehabilitimin e kolektorëve të largimit të ujërave të ndotura në drejtim të përmirësimit të këtij shërbimi dhe që ka ndikuar edhe në rritjen e kostove të operimit dhe të mirëmbajtjes;

- Duke njohur faktin që operatorët që operojnë në këtë sektor janë kryesisht shoqëri aksionare me pronar njësitë e qeverisjes vendore;

- Duke pasur parasysh problematikat e shumta të hasura nga operatorët gjatë procesit të aplikimeve për pajisje me licencë;

- Duke pasur parasysh që shlyerja e pagesës rregullatore nga operatorët vazhdon të mbetet në një nivel të ulët, duke ndikuar në ushtrimin e aktivitetit të ERRU-së;

- Duke njohur ERRU-në si autoritetin që miraton tarifat e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, bazuar në përballueshmërinë e këtyre pagesave nga ana e konsumatorëve;

- Duke konsideruar si shumë të domosdoshme kryerjen e investimeve nga operatorët për përmirësimin e shërbimeve që ata ofrojnë dhe duke qenë të vetëdijshëm për ndikimin e këtyre investimeve në rritjen e tarifave për këto shërbime;

Kostatoni se Enti Rregullator i Ujit në vitin 2013:

- Ka miratuar licencën e re dhe kushtet e saj, të cilat janë të detyrueshme për operatorët.

- Ka miratuar metodologjinë për vendosjen e tarifave, e cila krijon një lidhje të drejtpërdrejtë tarifë-performancë, duke ndikuar në rritjen e efikasitetit të shërbimeve në sektor.

- Ka sanksionuar për operatorët, që aplikojnë për rritje çmimi, detyrimin për zhvillimin e seancave dëgjimore me publikun;

- Ka përzgjedhur 10 treguesit kryesorë të performancës për të vlerësuar performancën e operatorëve, me qëllim që këta të fundit të angazhohen në ofrimin e shërbimeve më efikente e më cilësore.

- Ka miratuar instrumentin e Bilancit të Ujit, një instrument që, përveç operatorëve, u shërben edhe ERRU-së dhe njësisë të qeverisjes vendore për monitorimin e performancës së operatorëve, në lidhje me cilësinë e shërbimit.

- Ka publikuar dy raporte të performancës së operatorëve ujësjellës-kanalizime në sektor, ku shqyrtohet performanca individuale e operatorëve, krahasuar me atë të operatorëve të tjerë.

- Ka kryer inspektime në lidhje me verifikimin dhe saktësimin e të dhënave të operatorëve, që lidhen me treguesit kryesorë të performancës.

Kërkon nga Enti Rregullator i Ujit për vitin 2014:

- Të angazhohet në forcimin e pavarësisë institucionale dhe në ushtrimin e veprimtarisë së tij në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese;

- Të angazhohet në forcimin e kapaciteteve të tij administrative;

- Të jetë i vëmendshëm në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, për sa i përket cilësisë së shërbimeve të ofruara nga operatorët në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura;

- Të ketë parasysh gjetjen e balancës mes mbrojtjes së konsumatorit dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të

ofruesve të shërbimit, gjatë procesit të vendosjes së tarifave;

- Të vazhdojë të monitorojë performancën dhe ecurinë e shërbimit të operatorëve ujësjellës-kanalizime, në drejtim të përmbushjes së detyrimeve të tyre ndaj konsumatorit dhe t'i orientojë ata drejt efijencës së energjisë, e cila ka ndikim të madh në strukturën e kostos;

- Të angazhohet në një rregullim sa më të mirë të sektorit dhe përditësimin e standardeve të shërbimit në këtë sektor;

- Të vazhdojë të monitorojë të dhënat dhe zbatimin e tarifave të miratuara, si dhe Bilancin e Ujit për operatorët e ujësjellësve;

- Të vazhdojë të angazhohet në zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, pavarësisht mungesave të legjislacionit, për të marrë vendime për zgjidhjen e tyre;

- Të angazhohet në evidentimin dhe licencimin e operatorëve që shërbejnë në zonat e pambuluara me shërbime ujësjellës-kanalizime të licencuara;

- Të rrisë bashkëpunimin me aktorët që operojnë në këtë sektor, me shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit, si dhe me rregullatorët analogë të huaj.

Miraturar në datën 17.7.2014

KRYETARI
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 8625, datë 10.7.2014

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4, të Kushtetutës si dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Enkeledi Hajro, emërohet gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8626, datë 10.7.2014

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4, të Kushtetutës si dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Kastriot Gramshi, emërohet gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET

Nr. 8631, datë 16.07.2014

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Aviola Zeqir Lalaj
2. Gladiola Flamur Kraja
3. Gentiana Leka Eder-Shllaku (Shllaku)
4. Arlinda Zeqi Sihler (Kastrati)
5. Marsida Muço Hysaj
6. Beshir Dalip Qorri
7. Blendi Beshir Qorri
8. Livia Adriatik Maqellara
9. Jonida Lutfi Kopper (Saqe)
10. Ilir Halim Tatraku
11. Ledio Hajri Ceni
12. Emine Nazif Markwald (Diko)
13. Spiro Pavllo Foto
14. Branimir (Benimir) Niko Krstović (Nikollaj)
15. Ivan Branimir Krstović
16. Dušan Branimir Krstović
17. Adrian Stefanaq Zhamo

18. Raela Agron Zhamo (Dylçe)
19. Flavio Adrian Zhamo
20. Marsida Halit Sejdini (Subashi)
21. Aurela Hajri Kastrati (Zeka)
22. Jetmira Mehmet Demiri (Barci)
23. Maria Kostaq Mashali

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 36 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006